



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:291608

Datë: 17.07.2023

Numri i dokumentit: 04494603

PKR.nr.152/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Alban Ajvazi, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët profesionistë Sullatne Hoti dhe Avni Sylja, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.R.1 për shkak të veprës penale Vrasje nga neni 174 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.174/19 të dt.29.01.2021, e precizuar në shqyrtimin gjyqësor me datë 26.04.2023, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt.30.05.2023, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Besa Limani, i akuzuarit B.R.1 me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av. Skender Musa, të dëmtuarit SH.K, A.K dhe SH.K me përfaqësuesin e tyre sipas autorizimit Av. G.Z, i dëmtuari RR.K me përfaqësuesin e tij sipas autorizimit Av. Ramadan Sylejmani, me dt.02.06.2023 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa që me dt.17.07.2023 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarve:

B.R.1 i biri i Sh. dhe S., e gjinis K., i lindur me dt... në Lipjan, me vendbanim në rr. "...", Lipjan, i martuar, me profesion ujë-instales, i gjendjes së mirë ekonomike, ka të kryer shkollën mesme, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim prej dt.07.09.2019.

JANË FAJTOR

I akuzuari B.R:

Sepse

Me dt.07.09.2019 rreth orës 15:10 në rrugën "... " në Lipjan, derisa i pandehuri B.1 dhe vëllau i tij B.R.2 kanë qenë duke punuar pran lokaleve të tyre, dhe tani dëshmitari M.R, i cili ka qenë i angazhuar si punëtor tek të njëjtit, kishte shkuar për të hedhur karrocën me mbeturina betoni, në parcelën **nr.....**, në pronësi të babai të tani të akuzuarit SH.R, e cila pronë gjendje në fqinjësi me shtëpinë e tani të ndjerit F.K, me të cilin familja e të pandehuri B.1 kishin mosmarrëveshje për më shumë që 10 vite, pasi që tani i ndjeri F. ka kërkuar pronësinë mbi pjesën e kësaj parcele, të cilën e ka shfrytëzuar si rrugë kalimi, tani i ndjeri F. nuk e kishte lejuar që ta hudhte bërllokun duke kërkuar që të kthehej, dëshmitari M. ishte kthyer dhe e ka informuar B.2, i cili pas që ka biseduar me të akuzuarin B.1, i cili në ato momente ka qenë në oborr të shtëpisë, B.2 a ka marr

kolicen e mbushur dhe s'bashku me të akuzuarin B.1 janë nisur në drejtim të tani të ndjerit F., i cili ka qenë duke qëndruar në rrugën e cila ka qenë objekt kontesti, i ndjeri F.ju ka thënë "kthehuni mbrapa se nuk keni me zbraz kolicë me mbeturina këtu, ndërsa që B.2 ki kishte thënë se "pse nuk bën, unë bash këtu kam me e shpraz", pastaj tani i ndjeri F.i është përgjigjur "nuk guxon" dhe në atë moment nga aty ka marr me dorë një cev hekuri e rrumbullakët e gjatë 50cm, ndërsa që me dorën tjetër e ka kapur të akuzuarin B.1 për gjoksi dhe e ka goditur me cev një herë në kokë, një herë në shuplaken e dorës, të cilën i akuzuari B.1 e ka vendosur mbi kokë për të mbrojtur goditja, dhe njëherë në këmbë, pastaj pasi që është ofruar B.2, të njëjtin e ka goditur njëherë në gjoksi me gyp metali, dhe në atë moment i akuzuari B.1 e ka nxjerrë thikën nga xhepi i tij dhe e ka goditur 3 herë, dy nga të cilat kanë rezultuar prerje sipërfaqësore, ndërsa që goditja e fundit, në pjesën majtë të gjoksit në zemër, ka rezultuar vdekjeprurëse, pasi që si rrjedhojë e lëndimeve të pësuar, tani ndjeri F.K pas dërgimit në QKUK, nga plagët ka ndërruar jetë në Qendren Klinike Universitare të Kosovës,-

- Me këtë ka kryer veprën penal Vrasje në tejkalim të kufijve të mbrojtjes të nevojshme nga neni 172 lidhur me neni 12 par.3 dhe 4 i KPRK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 4,12,17, 38, 42, 69 KPRK-së, si dhe nenet 358, 360, 364, 367, 368, 449 dhe 462 të KPPRK-së, **të pandehurit i:**

G J Y K O N

Të akuzuarin **B.R.1 ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim e shqiptuar do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.07.09.2019 e tutje.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, detyrohen që t'i paguajnë shpenzimet dhe atë, shumën prej 300 (katërqind) Euro, si dhe në emër të fundit për kompensimin e viktimave shumën prej 50 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit SH.K, A.K, SH.K dhe RR.K, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit B.R.1, i vazhdohet paraburgimi me aktvendim të veçant, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 366 par.1 pika 1.1 lidhur me par.6 të KPPRK-së,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr.41/18 të dt.30.05.2018, kundër të akuzuarve B.R.1 dhe B.R.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje e rëndë nga neni 173, pika 1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-se dhe i pandehuri B.R.1 për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me date 21.04.2021 me aktgjykimin PKR.46/21, për pandehurin B.R.1 ka bërë ricilesimin e veprës penale dhe të njëjtin e ka shpalle fajtor për verën penale Vrasje nga neni 172 ndërsa ka liruar për veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për te pandehurin B.2 gjykata ka bërë riclesimn e veprës

penale dhe te njëjtin e ka shpalle fajton për veprën penale Pjesëmarrje ne rrahje nga neni 187 par 1 te KPRK-së.

Gjykata e Apelit ne procedurën ankimore me aktgjykim PAK.nr. 273/22 te datës 19.07.2022 ka refuzuar ankesën e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit te pandehurit B.R.1 dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë ndërsa sa i përket te pandehurit B.R.2 ka aprovuar ankesen e mbrotjesit dhe te pandehurin B.2 i ka ricilesuar veprën penale dhe te njëjtin e ka shpallë fajtor për veprën penale Sulmi nga neni 184 par 1 të KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin PML.nr. 414/2022 të datës 30.01.2023 ka aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit B.R.1 dhe ka anuluar aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit, vetëm sa i parkete veprës penale Vrasje nga neni 172 dhe këtë qështje e ka kthyer gjykatës se shkallës së parë për rigjykim.

Gjithashtu ka aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë për të pandehurin B.R.2 dhe të njëjtin Gjykata Supreme konform nenit 364 par 1 nen par 1.3 ka liruar nga akuza.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të lëndës me datë 28.03.2023, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 26.04.2023 ku prezent kanë qene Prokurorja e shtetit Besa Limani, i pandehuri B.R.1 me mbrojtësin e tij Skender Musa, të dëmtuarit SH., A. dhe SH.K me përfaqësuesin av. G.Z, i dëmtuari RR.K me përfaqësuesin av.Ramadan Sylejmani si dhe dëshmitaret, M.O, S.K, M.R, V.T, F.R dhe E.R.

Prokuroja e Shtetit para leximit të aktakuzës ka deklaruar se përkrimi faktik i dispozitivit te pare të kësaj vepre penale duhet të jetë si në aktgjykimin PKR.nr.46/21 të datës 21.04.2022 gjithashtu edhe kualifikime ligjore duhet të jetë i njëjti pasi që kemi të bëjmë vetëm me te pandehurin B.R.1 dhe pas leximit te aktakuzës i pandehuri ka deklaruar se e kuptoj aktakuzën dhe nuk e ndihen veten fajtor.

Gjykata duke u bazuar në nenin 323 të KPPRK-së, ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor me prezantimin e provave dhe fjalën përfundimtare.

Fjalët përfundimtare palëve dhe mbrojtja e të akuzuarve

Prokurorja e Shtetit pas administrimit të provave materiale, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht, ka deklaruar se, gjate shqyrtimit gjyqësorë në çështjen penale kundër te pandehurit B.R.1 , pas administrimit të gjitha provave dhe shqyrtimit te tyre, kemi ardhur në përfundim se përtej dyshimit te bazuar mire është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri B.R.1 ka kryer veprën penale të vrasjes nga neni 172 te KPRK-se dhe se në veprimet e te pandehurit në tërësi janë manifestuar të gjitha elementet e veprës esenciale te figurës se veprës penale për të cilën ngarkohet dhe që ishte objekt shqyrtimit. Gjendja faktike, se me datën 07.09.2019, rreth orës 15:10 në rrugën “...” në Lipjan, para shtëpisë se te tani te ndjerit F.K dhe shtëpisë se te pandehurit B.R.1 dhe familjes se tij me dashje ka privuar nga jeta, tani të ndjerin F.K, te cilin e ka pasur djalë te dajës, në atë mënyrë qe pasi dëshmitari M.R, kushëriri i afërt i te pandehurit B.1, derisa ishte duke punuar si punëtor të i pandehuri kishte shkuar për te hedhur karrocën me mbeturina betoni afër shtëpisë se tani te ndjerit F.K, përkatësisht në parcelën nr....., në pronësi te SH.R, për te cilën për 10 vjet kishin mosmarrëveshje në mes te dy palëve, tani i ndjeri F.K nuk e kishte lejuar qe ta hedhe mbeturinat me arsyetimin se i pengonte, ndërsa dëshmitari M.ishte kthyer prapa me karroce dhe e kishte informuar B.2 i cili kishte marre karrocën me mbeturina dhe i pandehuri B.R.1 me vëllain e tij B.R.2, ishin kthyer në vendin e ngjarjes për te hedhur mbeturinat ndërsa pas tyre ishin nisur dëshmitari M.R dhe me të mbërri, tani i ndjeri F.K iu kishte thënë “kthehuni mbrapa se nuk keni me zbraz kolicen me mbeturina këtu”, ku B.R.2 me vendosmëri i kishte thënë tani te ndjerit F.“un bash këtu kam me e shpraz”, dhe e ka lëshuar karrocën nga dora dhe pastaj i pandehuri B.1 me dashje qe ta privoj nga jeta, e ka goditur me thike të ndjerin F.K, tri here në regjionin e majte të kraharorit, me thike me teh 9

cm, prej te cilave një here në organ vital te zemrës, e cila ka qenë vdekjeprurëse pasi ka depërtuar në muskulin e zemrës duke depërtuar në barkushen e djathte dhe si pasoje tre lëndimeve ka pasur gjakderdhje te jashtme dhe te brendshme ku pas pak orësh ka ndërruar jetë në QKUK në Prishtinë. Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga deklaratat e disa dëshmitarëve dhe provave materiale te administruara në gjykate pranë këtij trupi gjykues. Sa i për ketë dëshmitarëve dhe provave materiale, mbetem pranë fjalës përfundimtare te datës 18 Mars 2022, vetëm sa i për ketë te pandehurit B.1 dhe veprës penale qe ishte objekt i shqyrtimit te fundit gjyqësorë. Gjithashtu me asnjë prove bindëse nuk është vërtetuar se tani i ndjeri F.ta ketë goditur i pari te pandehurin B.1, prandaj, deklaratës e dëshmitarit M.R nuk duhet falur besimi sepse qartazi vërehet se ky dëshmitar në asnjë rrethanë nuk ishte objektiv dhe i sinqertë, i cili ka theksuar se i ka pare vetëm veprimet e tani te ndjerit F.dhe se nuk kishte pare asnjë veprim te pandehurit B.1. Po ashtu ky dëshmitar ka theksuar se as qe është kthyer për te parë se në çfarë gjendje ishte tani i ndjeri F.. Pra, pse te falet besimi këtij dëshmitari jo kredibil e pse mos ti falet besimi dëshmitarëve okular A.K dhe M.O. Sipas Komentarit te Kodit Penal neni 12, par 10 b) thekson se mbrojtja duhet të jetë domosdo e nevojshme për zmbropsjen e sulmit prej vetes apo tjetrit, rrjedhimisht një mbrojtje konsiderohet e nevojshme në rastet kur konstatohet se sulmi nuk ka mundur te zmbropset pa iu shkaktuar ndonjë dëm sulmuesit, ndërsa në par 12 theksohet se “nuk ekziston mbrojtja e nevojshme nëse ndaj sulmuesit me shkop shtihet me revole, nëse në një rrahje përdoret thika, sëpata ose revolja”. Prandaj, i propozojte gjykatës qe te pandehurin ta shpalle fajtor për veprën penale te cilën e ka kryer me dashje direkte dhe dënojë sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuara SH.K, A.K dhe SH.K, Av. Gani Zybeli, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht, ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, duke shtuar se nga provat e administruar në këtë shqyrtim gjyqësorë e sidomos në rigjykim pa mëdyshje është vërtetuar se i pandehuri B.1 në ditën, kohën, vendin, mënyrën e përshkruar si në piken I te dispozitivi te aktgjykimit PKR.nr.46/2021 te datës 22.03.2022 ka kryer veprën penale Vrasje nga neni 172 te KPRK-se, kjo është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitareve si dhe nga provat materiale dhe rikonstruimi i vendit te ngjarjes. Pretendimet e mbrojtjes se i pandehuri në ditën dhe momentin kritike i pandehuri ka kryer veprën penale në mbrojtje te nevojshme dhe gjendje te tronditjes se forte mendore, janë te pabazuara, nuk gjejnë mbështetje në provat e administruara gjate këtij procesi gjyqësorë për arsye se për te ekzistuar njëra prej tyre apo që të dyja së bashku duhet e plotësohen kushtet e veçanta te para me ligj.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuara RR.K, Av. Ramadan Sylejmani në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht, ka deklaruar se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, qofshin provat personal siç janë dëshmitë e dëshmitarëve, po ashtu edhe nga provat materiale është vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në aktakuzë dhe në këtë gjendje faktike të vërtetuar ka propozuar që të akuzuarin B.1 të shpallë fajtor dhe të dënoj sipas ligjit. Fajësia e tij është vërtetuar nga raporti i autopsisë si dhe nga provat tjera te cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësorë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.1 R., av.Skender Musa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht, ka deklaruar se ë mbrojturi ynë B.R.1, ka pranuar veprimet e tij në këtë çështje penale si pasoje e te cilave ka ndërruar jete i ndjeri F.K por nuk ka pranuar cilësimin juridik të veprës penale Vrasje nga neni 172 i KPRK-së, për shkak se në veprimet e tij nuk janë plotësuar elementet e kësaj vepre penale por plotësohen elementet e Institutit të mbrojtjes së nevojshme neni 12 i KPRK-së lidhur me elementet e tronditjes së fortë mendore pasi që pa fajin e tij është sulmuar dhe me veprimet e tij ka mbrojtur trupin dhe jetën e tij dhe ka bërë përpjekje që të largoje te ndjerin i cili vazhdimisht e ka sulmuar dhe goditur pandërprerë në

kokë dhe pjese të tjera të trupit, ku dëshmohet me prova se ditën kritike i mbrojturi ynë ka pas lëndime. Konsiderojmë se është vërtetuar qëllimi i te mbrojturit tonë ka qenë që ta largoje tani të ndjerin e jo që ta vras, madje një gjë e tillë vërtetohet edhe me deklaratën e të mbrojturi tonë B.R.1, dëshmia e dëshmitarit E., M.si dhe me Raportin e Autopsisë ku shihet se fillimisht ka dy plagë që janë si gërvishtje dhe plaga tjetër ka qenë fatale. Gjykata në rastin konkret duhet të aplikojë Institutin e mbrojtjes së nevojshme nga neni 12 i KPRK-së, se i mbrojturi ynë B.R.1 ka privuar nga jeta duke u mbrojtur nga sulmi i kundërligjshëm, i atëçastshëm dhe real pasi që i ndjeri F.K e ka sulmuar dhe goditur vazhdimisht pa ndërprerë me cevë te hekurit në kokë dhe në trup të mbrojturin tonë B.R.1 dhe vëllain e tij B.R.2 dhe që pa asnjë dyshim ka vepruar në pajtim me nenin 12 te KPRK-së në lidhje me tronditjen e fortë mendore. Në si mbrojtje i propozojmë Gjykatës ta analizoje në mënyrë analitike komplet lëndën dhe shkresat e lëndës dhe dispozitat e Kodit penal që kanë të bëjnë me Institutin e mbrojtjes së nevojshme që rregullohet me nenin 12 te KPRK-së ashtu që të marre vendim të ligjshëm dhe të drejtë dhe te konstatoje se janë përmbushur elementet e te njëjtës dhe të mbrojturin tonë B.R.1 ta liroje nga përgjegjësia penale ashtu siç parashihet në Kod.I propozojmë Gjykatës, që te analizoj provat një nga një dhe te gjitha së bashku në mënyrë profesionale dhe objektive në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe KPK-së dhe të marre një vendim të drejt e në pajtim me dispozitën ligjore te nenit 363 par 1 nën par 1.1 dhe 1.2 i pandehuri te lirohet nga akuza pasi që vepra me te cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale si dhe ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësin penale për shkak se janë plotësuar te gjitha elementet e institutit te mbrojtës së nevojshme nga neni 12 par 1 dhe 2 i KPRK-se e cili thotë se: "Vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale" dhe par 2 "mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetës ose personit tjetër me kushte që karakteri i mbrojtës të jetë në proporcion me shkallen e rrezikut që paraqet sulmi". I mbrojturi ynë B.R.1 ka vepruar plotësisht në pajtim me këtë dispozite ligjore sepse me veprimet e tij ka zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe te atëçastshëm të ndërmarrë nga i ndjeri në proporcion me rrezikun e paraqitur për jetën e tij dhe te vëllait te tij.

I akuzuari B.R.1, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se do shfrytëzoj të drejtën e tij që të mos deklarohet, ndërsa që mbetet pran deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, gjegjësisht deklaratën e dhënë në Polici me dt.07.09.2018 ka deklaruar se ditën e ngjarjes rreth orës 14:30 derisa kanë qenë duke punuar në lokalin e tij s'bashku me të akuzuarin B.1 dhe tani dëshmitarin M.R, i cili ka qenë duke bartur material me kolic, për ti hedhur në një largësi prej 50-60 m, është kthyer M.me kolic në dorë, dhe i ka njoftuar se F.i, djali i dajës, nuk e ka lejuar me derdh bërrilokun. Janë nisur s'bashku me B.2n, i cili edhe e ka marr kolicen me material, kur kanë arritur te F.i , ka kërkuar të kthehen mbrapa, nuk janë kthyer, kanë vazhduar rrugën, dhe në at moment ka filluar të i godas, të akuzuarin B.1 e ka goditur me grusht në kokë dhe gype në kokë, për çka e ka mbuluar gjaku, ka pasur një thikë a shtrafziger dhe e ka goditur në barkë, pastaj i ka ndarë punëtori M., dhe një person tjetër, që nuk e din kush, prezent ka qenë edhe djali i F.it, emri i të cilit nuk i është kujtuar, i cili e ka sulmuar të akuzuarin me grushte. Janë larguar nga vendi i ngjarjes me veturën Tauran, të cilin e ka vozitur B.2a, fillimisht kanë shkuar në shtëpinë e shëndetit në Lipjan dhe pastaj në Prishtinë. I ndjeri F.i ka penguar, përkundër fakti se për shfrytëzimin e rrugës nuk i kanë penguar asnjëherë, e për këtë janë dëshmitar edhe mixha i tij K.K, dhe lidhur me këto pengesa 1 po 2 here e kanë lajmërua policin. Në prokuroi me dt. 07.11.2019 ka deklaruar ngjashëm sikurse edhe deklarata në polici, sa i përket veprimeve para momentit kritik, përkatësisht derisa pas njoftimit të M. janë nisur për të shkuar te F.i, ashtu që kur i janë ofruar të njëjtit 15 m, pasi që i ka vrejtur është nisur me shpejtësi në drejtim të shtëpisë së tij, dhe nga shtëpia ka dalur me një shipk të hekurit rreth 1m të gjatë dhe pafolur asnjë fjalë, e ka goditur me bokës në vetullën e majtë, pastaj është shtyrë me F.in, ka arritur ta largoj pak, pastaj a goditur me cev në kokë në pjesën e përparme, për çka ka nisur të i dal gjaku në fytyrë

dhe , për fat të keq ka pasur një thikë të punës me ngjyrë të kuqe, fillimisht është mundur ta shty F.in meqenëse ka qenë i trullësuar, dhe pastaj e ka therur me thikë në barkë, thikë të cilën e ka përdorur e mbanë që nga viti 2004, të cilën ja ka dhënë KFOR-i, qëllimin nuk e ka pasur për ta vrar, apo therur me thikë, por për ta larguar meqenëse ka qenë i gjakosur dhe trullësuar nga goditjet me shpik të hekurt që ja ka bërë F.i. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtjes dhe nuk ka asgjë për te shtuar.

Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktik në këtë çështje penale, gjykata ka dëgjuar dëshmitaret/të dëmtuarit SH.K, SH.K, A.K dhe RR.K, dëshmitaret E.R, M.R, M.O, S.K, V.T, si dhe ka administruar provat materiale: Lista e dëshmimeve e datës 07.09.2019 me provat që janë gjetur në vendin e ngjarjes dhe në veturën Tauran, e cila ka qenë në oborrin e QKUK-së; Raporti i autopsisë nr.MA19-240 i datës 21.10.2019, Plotësim raporti i datës 30.09.2020, raporti i ekspertimit nr. AKF/2019-2506/2019-2215 i datës 24.12.2019, Raporti i ekspertimit AKF/2019-2506/2019-2216 i datës 20.01.2019, Raporti i ekspertimit AKF/2019-2506/2019-22217 i datës 13.02.2020, Raporti i ekspertimit i datës 14.02.2020, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 07.09.2019, Raporti njoftues i datës 27.10.2019, Vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 07.09.2019, Procesverbal mbi kontrollin e personit dhe banesës i datës 07.09.2019, Shënim zyrtar mbi hyrjen në banesë dhe lokale tjera i datës 07.09.2019, Vërtetimi LRP.nr.5427/2018 i bërë të noteri Zyfer Aliu; Skica e vendit të ngjarjes; Tabela e matjeve në vendin e ngjarjes e datës 07.09.2019, fotoalbumi i dt.07.09.2019; Akt Ekspertimit mjekoligjor-raporti mjekoligjor bazuar në rekonstruimin e vendit të ngjarjes i dt.28.01.2022 i ekspertit mjekoligjor Naim Uka; Ekspertiza e gjeodezis e dt. 24.01.2022 e Gjeodetit Izjah Shala dhe Raporti i akt ekspertimit mjeko ligjore i dt.29.01.2022, mbi lëndimet e pësura nga tani i akuzuari B.1 dhe vëllau i tij B.2, janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve SH.R dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.11.2021, H.Z dhe N.V dhënë në polici me datë 10.10.2019.

Dëshmitarja SH.K në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se ka qenë bashkëshortja e të ndjerit F.me të cilin ka qenë në lidhje martesore për 21 vite, ndërsa që i ndjeri F.ka qenë në lidhje familjare me të akuzuarit B.2 dhe B.1, përkatësisht, të njëjtit i ka pasur djem të hallës, e që edhe ka qenë arsyeja pse dëshmitarja i ka njohur të njëjtit, me të cilët raportet familjare kanë qenë të mira, pasi që në atë vend kanë shkuar në të njëjtën kohë në vitin 2000, deri 5-6 vite pas luftës, kur familja R. ka blerë pronën e cila ka qenë kontestues ndërmjet tyre, e të cilën pronë familja K. por edhe krejt lagja e ka shfrytëzuar si rrugë kalim, dhe që për blerjen të cilës kanë kuptuar vetëm pas që i akuzuari B.1 dhe B.2, babai i tyre, kanë filluar të vendosin rrethoja, duke refuzuar në të gjitha rrethanat që të merren vesh paqësisht lidhur me këtë çështje. Më tutje ka theksuar se janë mundur që në mënyrë kanunore me i dhanë zgjidhje problemit të tyre, përmes një marrëveshje ta arritur përmes ndërmjetësuesve N.V dhe H.Z, mirëpo të akuzuarit nuk i janë përmbajtur duke shkuar te noteri dhe duke bërë një deklaratë, sipas të cilës, token do ta lënë në shfrytëzim, mirëpo nëse ndërtojnë diçka, e njëjta nuk do të mbetet rrugë, deklarata të cilën ua ka sjellë axha i burrit tim K.K, të cilin të pandehurit e kanë dajë, të njëjtën nuk e kanë pranuar meqenëse qasje në rrugë kanë pasur gjithmonë, zhurmë nuk kanë bërë, mirëpo ja kemi lan Zotit, katër familje janë bllokuar, vjehëri, kunetet dhe bashkëshorti, për me tepër e kanë shfrytëzuar dhe e shfrytëzojnë edhe sot të gjithë qytetarët e Lipjanit pasi që është rrugë e frekuentuar. Po ashtu ka shtuar se motra e të akuzuarve I.S ka shkuar tek halla e burrit të saj M.O të cilën e ka teze, dhe i ka thanë se B.2a ka deklaruar se “Kemi me vra F.in, e kurrë rrugën nuk kemi me zhbllokua, ajo rrugë është e jona”, duke i kërkuar njëherit që të “Mos i trego vëllezërve të mi pasi që ata me ditë më mbysin mua”, pastaj këto fjalë Miniria ja ka thënë gjithë familjes “Ruanu se po dojshin me ju vra dy të akuzuarit”, ndërsa që i ndjeri F.K ka thënë “Nëse kanë dajë për me vra le të më vrasin, ndërsa unë nuk kam nipa me vra”, e pastaj për ti penguar në kalimin nëpër

pronën kontestuese, kanë vendosur mjete të ndryshme, bager, voza të qelikt, e kupëza betoni, një bager i të akuzuarve ka ndejt afër lokalit të tyre, ku qiraxhit gjithmonë kanë pasur ankesa sepse nuk kanë mundur me ndejt prej erës së naftës dhe në një rast, i akuzuari B.2 i ka treguar djali të dajës së dëshmitares A.G, një revole, me të cilën ka thënë se do ta vras F.in, mirëpo që rastin nuk e kanë paraqitur në polici, duke pasur parasysh raportet në mes tyre, në këtë drejtim i është rikujtuar deklarata e dhënë në prokurori me dt:04.11.2019, ku ka deklaruar se “Po ashtu edhe B.R.2 përmes njerëzve kishte kërcënuar publikisht F.in duke thënë E kam blerë armën për ta vrasur F.in, këto fjalë i ka treguar xhaxhai i F.it, S.K, derisa ishte e pamja për vrasjen e F.it”, për çka ka deklaruar se kjo është e vërtetë. Më tutje ka shtuar se tani i ndjeri F.i ka punuar të gjitha punët, ndërsa kohet e fundit ka punuar sigurim në Zone Club, është marr me mish (kasap), me shitblerje të veturave, shëndetin e ka pasur shumë të mirë, pasi që ka pasur një gjatësi trupore mbi 1.90m dhe peshë trupor 135kg, sepse ka qenë sportist dhe ushtrues i fitnessit. Në ditën kur ka ndodhur ngjarja ka qenë tek familja në fshatin Gadime e Ulët dhe për rastin ka kuptuar rreth orës 15:15 min, fillimisht ka shkuar në shtëpi dhe pastaj në emergjencë, ku ka kuptuar se bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë. Në deklaratat e dhëna në procedurë paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me dt. 30.09.2019 ngjashëm ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në familjen e saj, nuk ka qenë në shtëpi, ndërsa që ka pohuar se para ngjarjes burri i saj tani i ndjeri ka pasur mosmarrëveshje të vazhdueshme me B.2n dhe B.1n që nga viti 2009, natyre e të cilave e ka shpjeguar ngjashëm sikurse dhe në shqyrtimin gjyqësor. Ndërsa që në deklaratën në Prokurori më dt.04.11.2019, ka deklaruar se nga 10 vite para ngjarjes nuk kanë pasur kurrfarë raporti me familjen R., pasi që SH. ka blerë truall me të cilin ua ka bllokuar daljen nga shtëpia, i ndjeri F. është munduar të gjejë një zgjidhje duke angazhuar ndërmjetësues, mirëpo për 4-5 vite asgjë nuk është rregulluar në këtë drejtim, pastaj kanë filluar pengesat, duke vendosur një bager, blloqe qeliku, e kocka të betonit, mirëpo tani i ndjeri F. nuk është përgjigjur. Po ashtu si në shqyrtim gjyqësor ka përmendur kërcënimin që ja ka bërë B.1u, për të cilin e ka kuptuar përmes hallës M, të cilën ja kishte treguar motra e B.1s, Ibadeti R. Sadiku, kur dëshmitarja i ka treguar F.i lidhur me këtë, F.i ka shkuar të Babai i të akuzuarve SH.R, dhe ka kërkuar që të i ndal djemtë të mos qesin këso fjalë se e kanë dajë, dhe se siç i është thënë nga xhaxhai i F.it, S.K, B.R.2 ndërmjet njerëzve kishte kërcënuar se “e kam blerë armën me vra F.in”, dhe për të njëjta Sokoli ka treguar gjatë mbajtjes së të pamës për F.in. Përkundër të gjithave, F.i nuk ka ndërmarr kurrfarë veprimi, sepse kërkesa e vetëm e F.it ka qenë që familja R. të ja liroj 4 metra rrugë sa për të mundur me kaluar.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e kësaj dëshmitare, të cilët dëshmi e ka gjetur, pjesërisht të bazuar, dhe atë vetëm sa i përket, faktit që ndërmjet familjes R. dhe K., ka pasur në vazhdimësi mosmarrëveshje sa i përket pronësisë në pjesën e truallit, të cilën familja K., e ka shfrytëzuar si rrugë kalimi, ndërsa që sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së kësaj dëshmitarja, lidhur me kinse pengesat që i kanë bërë familja R. para ngjarjes kritike, përkatësisht të akuzuarit B.1, pastaj, kërcënimet për vrasje të tani të B.2, të cilat kërcënime dëshmitares ja ka thënë personat tjerë, deklaratimet e tilla nuk gjejnë mbështetje në provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, kjo pasi që ndryshe ngase deklaroi kjo dëshmitare, lidhur me veprimet e familjes R. para ngjarjes në ditën kritike, se kinse i kanë penguar për të kaluar në pjesën e pronës të cilën e kanë shfrytëzuar deri atëherë, nga provat e administruar rezulton fakti se parcela nëpër të cilën kanë kaluar familja K., ka qenë pronë e familjes R., përkatësisht e regjistruar në emër të SH.R, pastaj, siç vërtetohet nga Deklarata mbi të drejtën e kalimit me shenjen LRP.nr.5427/2018 e dt.13.07.2018, vërtetohet se SH.R si pronar i parcelës, ka shprehur gatishmërinë, për lejjimin e shfrytëzimit si rrugë kalimi, deri në momentin e ndërtimit të objekteve të larta, dhe se këtë dokumente ja ka dërguar familjes K., që është e qartë se nuk kanë qenë të kënaqur nga kjo, pasi që ndryshe nga se thotë dëshmitarja SH. se tani i ndjeri F. ka kërkuar të ja liroj 4 metra rrugë sa për të mundur me kaluar, në të vërtetë kërkesa ka qenë kalimi pronësisë mbi të njëjtin të kësaj pjesë të parcelës, pasi në qoftë se kërkesa ka qenë lejjimi kalimit në 4 metra, atëherë një e drejtë

i tillë i është njohur dhe pranuar me deklaratën e dhënë, të referuar si më sipër, që vetë dëshmitarja thotë se nuk ju ka pëlqyer. Po ashtu pohimet kësaj dëshmitare se tani dëshmitarja M.O, i ka thanë se B.2a ka deklaruar se “Kemi me vra F.in, e kurrë rrugën nuk kemi me zhbllokua, ajo rrugë është e jona”, se B.2 i ka treguar djali të dajës së dëshmitares, A.G, një revole, me të cilën ka thënë se do ta vras F.in, se B.R.2 përmes njerëzve kishte kërcënuar publikisht F.in duke thënë e kam blerë armën për ta vrasur F.in, e që këto fjalë i ka treguar xhaxhai i F.it, S.K, derisa ishte e pamja për vrasjen e F.it, Gjykatë, gjen se përkundër deklarimeve të tilla rrethana e tillë mbetet e pa mbështetur në prova materiale, përveç se pohohet nga të gjithë dëshmitarët ku si burim të informatës i referohen thëniet e dëshmitareve M. E njëjta rrethanë, është bartur mes dëshmitarëve qoftë nga njëri apo tjetri. Ajo, që mbetet e rëndësishme për këtë Gjykatë është fakti se rasti në fjalë përkundër se rezulton të ketë qenë një shqetësim për dëshmitarët, të cilët disa prej tyre pohojnë ta kenë ditur para se të ndodhë ngjarja kritike, nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret që ta paraqisnin në polici, duke pasur parasysh problemet pronësore që kishin. Veprimi i tillë, do të materializohej dhe do të provohej përmes paraqitjes në polici, e cila pastaj do të përbënte një provë materiale.

Dëshmitari RR.K në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar gjyqësor ku ka deklaruar se është babai i të ndjerit F., ndërsa që të akuzuarit i ka djem të motrës, dhe se raportet me familjen R. i kanë pasur të mira, në vitin 1999 pasi që është kthyer nga Gjermania, e ka blerë truallin në Lipjan në rr.“...”, në të cilën kanë qenë dy shtëpi, pastaj kanë ndërtuar shtëpinë e F.it dhe garazhet, afër rrugës kontestuese. Më tutje ka shtuar se rruga që është kontestuese, ka qenë e gjerë prej 12 metra dhe e gjatë 10 metra, pastaj janë marr vesh me babain e të akuzuarit, SH.R, për ndërtimin e një garazhe në atë hapësirë, ndërsa që dëshmitari të dal drejt në rrugë, ashtu siç e shfrytëzon edhe sot, dhe kanë filluar të shfrytëzojnë pa pengesa deri pak para ngjarjes kritike, mirëpo ndërkohe, pronën në të cilën ka kaluar rruga e ka blerë SH. pa dijeninë e tyre dhe ju ka thënë që rrugë më nuk keni këtu, për çka edhe ka vendosur ceva të hekurit për me tregu ku është mexha/kufiri. Më tutje ka shtuar se si pasoj e mos marrëveshjeve, kanë angazhuar si ndërmjetësues, N.V dhe H.Z, ku për pak kohe është mundësuar shfrytëzimi rrugës, mirëpo, pas një muaji kur kanë filluar të shtrojë rrugën me kocka, SH. e ka dërguar vëllain e dëshmitarit, për të kërkuar të mos e shtro këtë rrugë se prona është e tij, ndërsa që SH. ka shkuar tek noteri dhe ka bërë një kontratë ku e ka cekur se kur të më duhet mua kjo pronë do e mbylli rrugën, vendim të cilin F.i nuk e ka pranuar, janë vendosur kamionë e rrugën e kanë bllokuar kohë pas kohë, dëshmitarit personalisht nuk i është kërkuar të **mos kaloj nëpër atë rrugë, mirëpo tani të ndjerit F.po** dhe se kjo mosmarrëveshje ka vazhduar për 10 vite, deri në ditën kritike, 07.09.2019. Në ditën kritike, ka qenë duke qëndruar në shtëpinë e tij, meqenëse ka qenë i ndarë nga F.i, anipse shtëpitë i kanë pasur në të njëjtin oborr, F.in e ka parë në shtëpinë e tij duke ushtruar boks pasi që në shtëpinë e tij e ka pasur thesin për ushtrime, djali i F.it, A.i është nisur për të shkuar në punë dhe duke i mbathur këpucët e ka parë ngjarjen dhe e kanë dëgjuar të gjithë zërin e tij duke bërtitur e duke thënë pse ma thërret babën, dëshmitari ka dal jashtë me bashkëshorten dhe dy motrat e tij Z. dhe Mn, dhe janë nisur drejt vendit të ngjarjes që ka qenë larg rreth 40 metra, kur ka dal tek dera e hyrjes së oborrit, e ka parë F.in duke hyrë në oborrin e tij, dorën e majte e ka mbajtur afër brinjëve për ta ndalur gjakun, 4-5 pika gjak i kanë rënë në kocka, dhe i ka treguar dëshmitarit se e ka therur me shtrafciger B.1a, e ka kap dhe e ka ulur në shkallë, e ka thirrur djalin E. dhe me veturë e kanë dërguar F.in në emergjence, dëshmitari ka dalur në rrugë në vendin ku ka ndodhur ngjarja, ku i ka parë B.1n dhe B.2n duke hyrë në shtëpi të tyre, i ka pyetur se çka ndodhi, B.2a është përgjigjur se kena me ju pre krejtve, këto fjalë i kanë dëgjuar edhe policet të cilët kanë qenë prezent në atë moment, **në vend te ngjarjes e ka parë policinë dhe thikën me gjakun e F.it, të cilën policia e kanë marr në kerrin e B.2s**, ku ka qenë e fshehur. Dëshmitari është pyetur lidhur me pohimin e tij në shqyrtim gjyqësor se tani i ndjerë F.i ka thënë se B.1a e ka therë me thike, ndërsa që në deklaratën që keni dhënë në prokurori me datë 16.01.2020, ka deklaruar “B.1a

më ka therë me shtrafciger, ndërsa B.2a më ka goditur me dru në qafë”, për çka ka deklaruar se të dyja janë të vërteta. Në deklaratat e dhëna në procedurë paraprake, përkatësisht në deklaratat e dhënë në Polici me dt.08.10.2019, ka deklaruar se kur kemi dalur e kam parë F.in duke u kthyer te dera e oborrit dhe i ka thënë se e ka therr B.1a me shtrafciger, ndërsa me dru e ka goditur në qaf B.2a, se është goditur kogja fort por po e përballon. Në deklaratën në Polici me dt.07.09.2019, ka deklaruar se kur ka dalur e ka parë F.in duke hyrë të dera, ishte i gjakosur dhe i ka thënë që e ka ther B.1a me shtrafciger. Ndërsa në deklaratën që keni dhënë në Prokurori me datë 16.01.2020, ka deklaruar se raportet me familjen R. i kanë prishur rreth 7-8 vite para ngjarjes, përkatësisht në kohën kur e ka kuptuar se SH.R e ka blerë një pjesë të oborrit të tij, blerje të cilën e ka bërë me falsifikim, pastaj e ka qit murin dhe e ka penguar për të kaluar nëpër rrugën që e ka shfrytëzuar deri atëherë, dhe përkundër kërkesave për lirim të rrugës, SH. nuk ka pranuar. Se dite kritike, pasi ka dëgjuar A.in duke thënë “pse ma keni therë babën”, ka dalur në s’bashku me gruan e tij, pasi që M. kishte dal më parë, ku ka dal e ka pa F.in duke e mbajtur dorën në bark, i kanë pikur disa pika gjaku dhe i ka thënë dëshmitarit “B.1a më ka therë me shtrafciger, ndërsa B.2a më ka goditur me dru në qafë”, ndërsa që në ato momente ka parë B.1n dhe B.2n duke ikur dhe hyrë brenda në oborrin e tyre dhe B.2a e ka shar me fjalë fyese “nanen kemi me ja q..., pa ju mbytt krejtve nuk kemi me ju lanë”, ndërsa që ky ju ka thënë zoti ju marroftë dhe me shpejtësi e kanë dërguar F.in, fillimisht në ambulanten në Lipjan dhe pastaj në emergjencë në Prishtinë. Po ashtu ka shtuar se pas ngjarjes, djali i tij E. i ka treguar se disa muaj para ngjarjes I. i kishte thanë motrës së dëshmitarit Ms, që B.1a dhe B.2a kanë thënë se donë me vra F.in, e kjo i kishte treguar tani dëshmitares SH., e cila nuk e kishte bërë këtë punë të madhe.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur të bazuar dhe atë vetëm sa i përket, raporteve të përkeqësuar familjare me familjen R., ndërsa që sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari, deklaratimet e tilla nuk gjejnë mbështetje në provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor por ka kundërthënë edhe brena vetës, kjo pasi që në njërin anë pretendon se familja R. kanë vendosur gjësende të ndryshme për penguar kalimin nëpër rrugën kontestues, ndërsa që në anën tjetër deklaroi se vetë dëshmitarin nuk e kanë penguar për të kaluar, por e kanë penguar tani të ndjerin F.. Pastaj, pohimi i këtij dëshmitari se ajo pjesë e shfrytëzuar si rrugë ka qenë e vetmja rrugë kalimi, për djalë në rrugë kryesore, po ashtu është në kundërshtim me vetë pohimet e këtij dëshmitari se pas ardhjes së tyre në atë vend, janë ndërtuar objektet, të cilat edhe e pamundësojnë daljen në rrugë, objekte këto të ndërtuar nga vetë kjo familje, por është në kundërshtim edhe me prova tjera të administruara, përfshirë ekspertizën ekspertiza e gjeodezisë e dt. 24.01.2022 dhe deklarin e ekspertit Izjah Shala me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, sipas të cilit gjithsecila nga ato parcela ka dalje në rrugë. Edhe sa i përket, pohimit të këtij dëshmitari, se tani i ndjeri F.i ka thënë se B.1a e ka ther me thikë, ky pohim është në kundërshtim me atë që ka thënë me rastin e deklarin në Prokurori ku ka pohuar se tani i ndjeri i kishte thanë se “B.1a më ka therë me shtrafciger, ndërsa B.2a më ka goditur me dru në qafë”, për çka edhe është ballafaquar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, mirëpo që nuk ka dhënë një arsyetim bindës për këto deklarime të ndryshme, duke u mjaftuar me përgjigjen se të dyja janë të vërteta, dhe siç është vërtetuar tanimë bindshëm nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, tani i ndjeri F. është goditur me thikë, që një pohim të tillë, tani ndjeri F. të ja ketë thënë dëshmitarit, i cili për më tepër, një rrethanë kaq të rëndësishëm nuk e ka përmendur fare në deklaratën e parë të dhënë në Polici me dt.07.09.2019. Kjo bëhet dhe me bindëse, nga pohimi tjetër i këtij dëshmitari, që rezulton i pa mbështetur në prova tjera se pas përfundimit të ngjarjes tani i B.2a i është drejtuar me fjalët “se kena me ju pre krejtve”, që këto fjalë i kanë dëgjuar edhe policet të cilët kanë qenë prezent në atë moment, dhe se e ka parë policinë dhe thikën me gjakun e F.it, të cilën policia e kanë marr në kerrin e B.2së, kjo pasi që duke filluar nga rrethana e fundit, siç vërtetohet nga provat e administruara, thika është marr nga Policia, në veturën e tipit Tauran e cila ka qenë e parkuar në oborrin e QKUK-së, nuk janë provuar deklarinimet e dëshmitarit RR.K, se me të parë të ndjerin F. duke e mbajtur dorën afër

brinjëve për ta ndaluar gjakun dhe ka deklaruar se i ndjeri i kishte thënë se “B.1a më ka therë me shfraciger, ndërsa B.2a më ka goditur me dru në qafë”. Rrethanat e tilla, nuk gjejnë mbështetje në raportin e autopsisë nr.MA19-240 i datës 21.10.2019 i përpiluar nga eksperti Dr.Naim Uka, ku janë evidentuar lëndimet e pësuar tek i ndjeri dhe të cilat janë konstatuar në regjionin e sipër të majtë të gjoksit, dhe janë shkaktuar me mjet të fortë dhe të mbrehtë. Prandaj, në këtë kontekst deklarimet e dëshmitarit nuk mbështeten në provën materiale që dokumenton lëndimet vdekjeprurëse tek i ndjeri dhe mjetin që i ka shkaktuar ato.

Dëshmitari A.K në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se ditën kritike, ka qenë brenda në shtëpi duke shikuar TV, me babin e tij, tani të ndjerin F., i cili ndërkohë ka dal jashtë, dhe pas një ose dy minutave ka dëgjuar disa britma të vogla dhe ka dal më vrull jashtë shtëpisë, nga oborri i shtëpisë nuk ka mundur të shoh asgjë pasi që ka qenë një lis aty dhe pengon pamjen, derisa kur ka dal para dyerve të oborrit, në distancë prej 10 metra, aty e ka parë të akuzuarin B.1 që e ka pasur shfracigerin në dorë, e ka therë në pjesën e zemrës, njëherë me shfraciger të ndjerin F., dhe ka tentuar prapë 2-3 herë që ta godas, më pastaj i akuzuari B.2 e ka goditur në kokë me stupc të drurit për afërsisht gjysme metër i gjatë, gjithashtu të akuzuarit B.2, B.1 dhe E. R. e kanë sulmuar me gur, duke sharë dhe ofenduar nga distanca, ndërsa që i ndjeri F.me një dorë e ka mbajtur plagën, ndërsa me dorën tjetër është munduar me u mbrojt. Më tutje ka shtuar se kur kanë shkuar në vendin e ngjarjes s’bashku me hallën M.O, kanë filluar ta tërheqin tani të ndjerin F., i cili ka qenë duke qëndruar në këmbë, maicën e ka pas plot njolla gjaku, bashkë me gjyshin tani dëshmitarin R., e kanë vendosur në veturën e gjyshit dhe e kanë nisur për në emergjencë. Më tutje ka shtuar se me gur e kanë goditur të ndjerin F.dhe hallën M nga distanca, dhe se kjo ka ndodhur gjatë tërheqjes së të ndjerit F., nuk e ka pa nëse janë goditur nga gurën, mirëpo meqenëse M. ju ka thënë nalnu mos gjuani, kjo nënkupton se e kanë goditur, ndërsa babai tani i ndjeri F.ka filluar me u mbrojtje me duar, ndërsa që ofendimet kanë qenë, B.1a ka thënë “këna me ju myt skena me ju lënë gjallë”, ndërsa E. e ka sharë “ta q... nanën dhe lëna rehat”, pastaj ka pohuar se kur është goditur tani i ndjeri F.nuk e ka parë, mirëpo vetëm e ka parë duke e mbajtur plagën dhe duke tentuar me goditë, që sipas tij ka ndodh gjatë tërheqjes së të ndjerit F., e që nga tentimi për ta goditur të njëjtin qenë i rrezikuar edhe vetë, në ato momente, i ndjeri F.edhe është goditur në qafë me stupc të drurit ne gjatësi rreth 1 metër. Në vijim të dëshmisë, përsëri ka përshkruar rrethanat e përmendura më herët, se ka qenë në shtëpi, duke shikuar TV, shtëpi e cila është në distance prej 15 metra, nga vendi i ngjarjes, ka dëgjuar “britmën e shufrës që ka rënë në tokë”, dhe pasi që i është kujtuar fakti që me herët ka deklaruar se ka dëgjuar edhe britmën e babait, është përgjigjur se ka dëgjuar të dyja ato, derisa që në vazhdim të dëshmisë i është rikujtuar deklarata e dëshmitarit RR.K i cili ka deklaruar në shqyrtimin e datës 02.07.202, se “F.in e kam parë në shtëpinë e tij duke ushtruar boks, pasi që në shtëpinë e tij e ka pasur thesin për ushtrime... djali i F.it A.i është nisur për të shkuar në punë dhe duke i mbathur këpucët e ka parë ngjarjen, dhe kam dëgjuar me të gjithë zërin e tij duke bërtit dhe duke thënë pse ma therët babën”, për çka është përgjigjur se babai ka qenë në garazh duke bërë zhurmë me disa haletë dhe nga aty më vonë e ka dëgjuar zhurmën, se ka qenë duke shikuar TV dhe gjyshi nuk ka mundur me pa se ku ka qenë dëshmitari. Sa i përket, raporteve familjare para ngjarjes, ka theksuar se ashtu konkret nuk ka dal askush nga familja R. të ju thotë të mos i bini asaj rruge, mirëpo kanë dal fjalë se B.1 R. ka blerë armen për me vratë ndjerin babain tim. Në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me dt.08.10.2019, ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në shtëpi vetëm me babin, ndërkohë që babai kishte dal, ka dëgjuar një zhurmë, kur ka dal e ka pa babain e tij që ishte në këmbë duke mbajtur plagën me dorën e djathtë, e me dorën e majtë duke u mbrojtur dhe duke i sulmuar B.2n dhe B.1n, ndërsa që afër tij kanë qenë B.2a dhe B.R.1, është nisur drejt babait, B.2a e ka hedhur stupcin e drurit nga dora, ndërsa që B.1a me shfraciger është munduar edhe njëherë me sulmu Babain në zemër, e ka kapur babain me tërheq, prezent ka qenë edhe halla M.O, ndërkaq që B.1a dhe B.2a kanë

vazhduar të i sulmojnë duke ju hedhur gur. Ka shtuar se është i sigurt që mjete në dorën e B.R.1 ka qenë shtrafçiger në madhësi sa gjysma e fletës së bardh A4, dhe prezent në vendngjarje kanë qenë B.2a dhe B.1a, babai F.i, dhe halla M.O. Ndërsa në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.24.06.2020 ka deklaruar se pasi që ka dal meqenëse i kishte dëgjuar disa britma, ka vërejtur B.1 dhe B.R.2 të cilit ishin duke e sulmuar babain e tij, i cili ishte i plagosur dhe me dorën e majtë mbante pjesën e pasme të kokës, ndërsa që me dorën e djathtë mbante plagën që kishte në pjesën e përparme-të majtë të gjoksit. Ka bërë titur, me c 'rast e ka dëgjuar gjyshi RR.K, i cili ka ardhur aty, ndërsa që B.1a dhe B.2a kanë vazhduar të gjuajnë me gur të mëdhenj, e kocka trotuari në drejtim të tyre. Aty ka qenë edhe halla M.O e cila ka qenë me të në oborr kur ka dal për të parë se çka po ndodh.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, lidhur me rrethanat kryesore për të cilat është deklaruar ky dëshmitar, në tërësi deklaratimet e tij janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë, dhe provat materiale, dhe atë duke filluar nga pohimi se tani të akuzuari B.1 i ka parë shtrafçiger në duar, me të cilin edhe ka tentuar ta godas tani të ndjerin F., mirëpo tanimë rezulton e vërtetuar fakti thika që është sekuestruar nga vetura me të cilinë i akuzuari B.1 dhe vëllau i tij B.2 janë bartur për trajtim mjekësor, rezulton se e njëjta është përdorur si mjete i kryerjes së veprës penale, e që edhe dëshmitarja M ka pohuar se tani i ndjeri F.i ka thanë se B.1a e ka ther me thikë, e po ashtu edhe vetë i akuzuari B.1 e ka pohuar se tani të ndjerin F.e ka goditur me thikë, thikë e cila i është sekuestruar pas ngjarjes në dirën kritike. Po ashtu edhe sa i përket pohimit të këtij dëshmitari se tani i akuzuari B.2, e ka goditur me stupc në qafë tani të ndjerin F., gjen se përkundër deklaratimeve të tilla rrethana e tillë mbetet e pa mbështetur në prova materiale, duke pasur parasysh se nga Raporti i autopsisë nr.MA19-240 i datës 21.10.2019 dhe Plotësim raporti i datës 30.09.2020, të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Naim Uka, nuk rezulton se në trupin e të ndjerit të jenë konstatuar çfarëdo lloji lëndime në qafë apo në kokën e tij, pastaj, rezulton i paqëndrueshëm dhe pohimi i këtij dëshmitari që me rastin e daljes në vendin e ngjarjes, vetëm është ofruar tek tani ndjeri F.dhe ka filluar tërheqjen e tij, pasi që siç e ka pohuar edhe vetë, me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, me rastin e daljes në venin e ngjarjes ai ka filluar ta godas B.2n, e që kjo konfirmohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit E.R., Gjykata, vlerëson se edhe pohimet e këtij dëshmitari në shqyrtim gjyqësor me natyrë kontradiktore, si p.sh, se gjatësia e stupcitet ka qenë njëherë gjysmë metër, e herën tjetre një metër, dhe për me tepër njëherë se ka dëgjuar zhurmën përleshjes, e herën tjetër se ka dëgjuar tingëllimën e shufrës që ka rënë në tokë, zhveshin nga çfarëdo lloji besueshmërie në dëshminë e këtij dëshmitari, i cili pretendon se ka dëgjuar në largësi prej 15 metra, derisa ka qenë brenda në shtëpi, duke shikuar TV, tingëllimën e shufrës që ka rënë, derisa që në vazhdimësi ka pohuar se në duar e tani të akuzuarit B.2 ka parë një stupc të drunit?! Po ashtu edhe pohimet e këtij dëshmitari se B.1a ka qit fjalë se ka blerë arme për me vra babain e tij tani të ndjerin F., janë plotësisht të paqëndrueshme, pasi që edhe dëshmitarja M, e cila pretendon se motra e te akuzuarit, Ibadete R. ka thënë ruane F.in se po dojnë me vra, ka pohuar se për këtë i ka treguar vetëm dëshmitares SH.K, ndërsa që dëshmitari RR. ka pohuar se e ka kuptuar pas ngjarjes, e që rezulton se babait të tani të ndjerit F., tani dëshmitarit Rr. nuk i është treguar për kërcënimin, ndërsa që dëshmitarit A. po, përmes tepër edhe është biseduar në shtëpi për këtë çështje.

Dëshmitari SH.K në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmis dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se raportet në mes familjes K. dhe R. janë acaruar para 10 vitësh, duke i marr parasysh provokimet që janë bërë nga familja R., familjes K., lidhur me një pronë të cilën të njëjti e kanë blerë, duke tentuar ta mbyllin rrugën e vetme që kanë pasur qasje, duke tentuar që rrugën ta bllokojnë me stuba të betonit, duke

zhvendosur mbetje materiale, ceva të ujit, derisa edhe bagerin e kanë prurë para shtëpisë tyre, duke ua vështirësuar daljen nga shtëpia dhe kyqjen në rrugën kryesore, për çka edhe në bashkëpunim me komunën e Lipjanit, inspektorët kanë ardhur dhe i kanë largu pengesat dhe babai e tij iu ka thënë inspektorëve se nëse ka një shpi pa rrugë dikund në Kosovë, shtëpia ime do të jetë e dyta. Më tutje ka shtuar se një vit para ditës kritike nuk kanë pasur pengesa nga të akuzuarit, ditën kritike ka qenë në pushime në Ulqin, nga ku është kthyer në të njëjtën ditë dhe nga nëna e tij, e ka kuptuar se çka kishte ndodhur. Në deklaratat e dhënë në procedurën paraprake, në deklaratën e dhënë në Polici me dt.30.09.2019 ka deklaruar se problemet me familjen R. kanë filluar para 10 viteve, kur familja R. ka vendosur shenja nëpër oborrin e familjes K., për çka janë detyruar të i largojnë sepse andej ka qenë e vetmja mënyrë për të dal nga oborri i shtëpisë. Provokimet dhe pengesat ka qenë të vazhdueshme, para 6-7 vitesh kanë vendosur bager, të cilën e kanë hequr vetëm pasi i ka detyruar Policia, ndërkohë pas rregullimit të parkingut të Komunës, Sh.R. s'bashku me inspektor komunal kanë tentuar me blloku rrugën e hyrjes në shtëpi, për çka tani i ndjeri F. është fjalosur me inspektor dhe i ka largu nga aty, përsëri pas 2 apo 3 muajve janë vendosur pengesa, të cilat i kanë larguar inspektorët komunal, duke thënë se shtëpi pa rrugë nuk ka dhe nga atëherë nuk ka ndërmarr asgjë as policia dhe as Komuna. Më tutje ka theksuar se B.R.2 ka qar fjalë përmes tezes së tij M.O se ka me vra F.in nëse na pengon, e po ashtu kërcënime të tilla ka qar edhe përmes S.Kt, se ka ble armë për me vra F.in, mirëpo që babai i tij, F.i gjithmonë ka kërkuar që të merren vesh përmes një kontrata që i garanton për gjithmonë rrugë të kalueshme në katër metra gjerësi, mirëpo ka marr një kontratë mashtruese, e cila nuk garanton se me vonë nuk do bllokohej rruga, e që kjo rrugë do mbetet prapë në emër të SH.R. Lidhur me kontestin pronësor me familjen R. nuk e kanë lajmëruar asnjëherë Policin, mirëpo që sa herë ka pasur mosmarrëveshje në mes familjes R. dhe K., posaçërisht me tani të ndjerin F., gjithmonë familja R. e ka lajmëruar Policin. Ndërsa që në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.24.06.2020, ka përshkruar lëndimet që sipas tij i ka konstatuar në trupin e të ndjerit F. që sipas tij në pjesën e pasme të kokës ka pasur një gërvishje prej 4 cm, e cila ka qenë e mavijosur, e cila sipas tij ka qenë e shkaktuar me ndonjë shkop. Lëndim tjetër ka qenë në pjesën e majtë të gjoksit, ku ka vërejtur tri vrime, dy prej të cilave janë vërejtur se janë shkaktuar prej mjetit të fort shtrafciger dhe jo me thikë, ndërsa që lëndimin që ka vërejtur nën krahun e majtë, afër zemrës dhe në bazë të formës së prerjes vërehet që është shkaktuar nga goditje me thikë.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari të cilën dëshmi e ka gjetur si të bazuar, dhe atë vetëm sa i përket pohimit të këtij dëshmitari se një vit para ditës kritike nuk kanë pasur pengesa nga të akuzuarit, anipse siç është vërtetuar edhe provat tjera të administruar në këtë çështje penale, familja R. përkatësisht të akuzuarit B.1 dhe vëllaut të tije B.2s, asnjëherë nuk i kanë penguar familjen K., përkatësisht tani të ndjerin F. për të shfrytëzuar si rrugë një pjesë të parcelës në emër të babait të tyre, dhe se nuk ka qenë objektit mosmarrëveshje e drejta e kalimit, të cilën të drejte familja R. ja ka pranuar, familjes K., mirëpo pengesë në arritjen e marrëveshjes ka qenë kërkesa që pjesa e parcelës nëpër të cilën kalon rruga të kalojë në emër të familjes R. përkatësisht tani të ndjerit F.K, dhe se kjo rrethanë pohohet edhe nga ky dëshmitar në deklaratën e dhënë në Polici me datë 30.09.2019, ka deklaruar se i'u është ofruar një "kontratë mashtruese, pasi që rruga prapa do mbetje në emrin e SH.R", e që ky pohim i këtij dëshmitari, është në përputhje edhe me dëshminë e dëshmitarit SH.R se nga Familja K., përkatësisht nga tani i ndjeri F., i është kërkuar pronësia në pjesën e parcelës nëpër të cilën ka kaluar rruga, që është shfrytëzuar nga të njëjtat. Gjykata vlerëson se sa i përket pohimeve të këtij dëshmitari, por edhe dëshmitarëve tjerë siç janë dëshmitari A.K dhe S.K mbi lëndimet e pësuar nga tani i ndjeri F., tanimë janë administruar në cilësinë e provës materiale Raportit të Autopsisë me nr. të referencës MA19-240, të datës 21.10.2019, Plotësim raportit të datës 30.09.2020 të F.Kt, dhe Akt Ekspertimit mjekoligjor-raporti mjekoligjor bazuar në rikonstrukcionin e vendit të ngjarjes i dt.28.01.2022, nga të cilat ka vërtetuar pakontestueshme natyrën dhe vendin, dëmtimeve që janë konstatuar në trupin e tani të ndjerit F..

Me propozimin e prokurorit të shtete dhe pëlqimin e palëve është lexuar dëshmia e SH. R. dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 04.11.2021, ku ka deklaruar se i ndjeri F.K ka qenë djali i vëllait të bashkëshortes së tij, dhe deri në vitin 2005 me familjen K. me të cilën kanë qenë në fqinjësi, kanë pasur raporte shumë të mira, raport ky që ka reflektuar dhe në faktin që pasi fillimisht ka qenë dëshmitari që e ka blerë truall në atë vend, dhe pastaj duke qenë në marrëdhënie të mirë me RR., babain e të ndjerit F., i ka ndihmuar që edhe i njëjti të blej truall një fqinjësi, mirëpo në vitin 2005 kur ka filluar të ndërtoj një objekt të madh, ka dalur i ndjeri F.i dhe me ka thënë që ke hyre ne prone tonën dhe me atë rast, punën e ka ndaluar dhe nga kanë angazhuar gjeodetën për kryerje matjen, me c’rast është konstatuar se familja K. ka ndërtuar lokalin 60 cm në pronë e dëshmitarit. Më tutje ka shtuar se më vonë ka blerë 5 ari nga një serb, truall i cili ka qenë i kufizuar me pronën e tij dhe parkingun publik, dhe se përkundër fakti që familja K. ka ndërtuar dy lokale duke ja pamundësuar vetës dalje në rrugën kryesore nga trualli tyre, dëshmitari ka pranuar që një pjesë të truallit të ua lëshoj për rrugë, ashtu që është dakortuar që 7 metra të shfrytëzohen nga familja K. dhe se lidhur me këtë kanë nënshkruar edhe deklarat tek noteri për lëshimin në shfrytëzim atë pjese derisa të ndërtohet ndërtim i lartë, mirëpo i ndjeri F.nuk ka qenë i kënaqur me këtë dhe ka kërkuar që kjo sipërfaqe e tokës të kaloj në emër të tij, gjë që dëshmitari nuk ka pranuar, dhe për këtë tani i nderi F., dëshmitari i kishte shkuar tek vendi i punës dhe e kishte kërcënuar se ka me ta vra B.1n, policin e kishte njoftuar për rastin, mirëpo raport lidhur me këtë nuk kishte pranuar të bëj, duke pasur parasysh relacionet familjarë ndërmjet veti, e edhe pas këtij rasti derisa sa B.1a ka qenë duke shkuar në qytet bashkë me djalin e vëllait të F., J., tani i ndjeri F.i kishte thënë a po vjen mbas objektit ta nxjerri zemrën. Sa i përket ditës kritike, në momentin kur ka ndodhur ngjarja nuk ka qenë në shtëpi, mirëpo kur është kthyer, në oborr ka dëgjuar zhurmë, fillimisht e ka parë tani dëshmitaren M, e cila nuk i ka treguar lidhur me ngjarjen, pastaj mbas nja 50 metra duke u afruar tek shtëpia e ka parë B.1n të gjakosur, B.2a duke hyp në kerr për me qu në ambulante, ndersa reja dhe gruaja duke qajtur, ndërkohë Rr. kish qenë tek djemtë afër atyre dhe i ka bërë hygjym për me më ra mirëpo dikush e ka larguar, më shumë nuk ka vrejtur, mirëpo e gjithë ngjarja ka ndodhur në tokën te tij, konkretisht në ato përafërsisht 5 ari që i kam blerë më vonë dhe se nga bashkëshortja është informuar se B.1un e ka sulmuar dhe përgjakur F.i, ndërsa që në ato momente është ndaluar nga policia për të dhënë deklaratë dhe nga të njëjtit është njoftuar se është gjetur një thikë në veturën e tij, veturën me të cilën B.1a dhe B.2a janë dërguar në spital. Po ashtu edhe ne deklaratat e dhëna në procedure paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me dt.07.09.2019 dhe në Prokurori me dt.19.02.2019, në mynyrë të ngakshme ka deklaruar lidhur me raportet me familjen K. dhe natyrën e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, dëshmi të cilën e ka vlerësuar si plotësisht të sinqert, reale dhe objektive, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm, faktin mbi gatishmërinë e familjes R. për zgjidhje të mosmarrëveshjes lidhur me pretendimin e familjes K. për të drejtën e kalimit-rrugës nëpër një pjesë të pronës së tij. Dëshmia e këtij dëshmitari, është në përputhje, jo vetëm me deklaratat që ky dëshmitar ka dhënë në procedurën paraprake, mirëpo edhe me provat materiale, siq janë ekspertiza e gjeodezisë e dt. 24.01.2022 e Gjeldetit Izjah Shala nga ku vërtetohet se i njëjti është pronar i parcelës, një pjesë e të cilës është kërkuar nga familja K. të shfrytëzohet si rrugë, e po ashtu edhe me deklaratën mbi të drejtën e kalimit me shenjen LRP.nr.5427/2018 e dt.13.07.2018, nga ku vërtetohet bindshëm fakti se dëshmitari si pronar i parcelës,..., ja kishte njohur dhe pranuar të drejtën e kalimit-rrugës, duke i siguruar në mungesën e çfarëdo pengese nga ana e tij, duke e ruajtur vetem të drejtën e titullarit të pronës, të cilën të drejte nuk ka pranuar ta bartë, në emër të tani të ndjerit F., siq ka kërkuar i njëjtit, anipse për familjen K., kjo rruga nuk ka qenë e vetmja mundësi për kalim, duke qenë se siq ka pohuar edhe ky dëshmitar, mirëpo është vërtetuar edhe me provat tjera materiale, parcelat e familjes K. kanë

qenë me dalje në rrugë, dhe se në të vërtetë kanë qenë vetë ata të cilat përmes objekteve të ndërtuar, ja kanë pamundësuar vetës daljen në rrugë, mirëpo që përkundër kësaj, dëshmitari kishte pranuar lejimin e të drejtes së kalimit nëpër një pjesë të pronës së tij, duke bërë edhe deklaratë të posaçme për këtë.

Dëshmitari M.O në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar të akuzuarit i ka djem të motrës, ndërsa që tani të ndjerin F.e ka pasur djalë të vëllait, raportet tyre kanë qenë të keqësuar 10 vitet e fundit, si rrjedhojë e kontestit që ka lindur me herët, pasi që fillimisht në atë vend është vendosur Rr., edhe pastaj ka ardhur familja R., dhe problemi ka lindur ku i akuzuari B.1a dhe famija e tij, ia kanë mbyllur derën e oborrit dhe nuk ka muajt me kalu Rr. me familje të tij, rrugë e cila paraprakisht ka ekzistuar, dhe në pronësi të komunës dhe se lidhur me këtë, një vit para ditës kritike, motra e të akuzuarit B.1, I.S, kishte shkuar në shtëpinë e dëshmitares dhe i kishte thënë “Teze B.2a me B.1në kanë vendos me vra F.in”, dhe për këtë i kishte treguar gruas së tani të ndjerit F., e cila e kishte treguar të njëjtit, mirëpo ai kishte thënë “në paqin dajë me vra le të më vrajnë, a unë skam nipa me vra”. Në ditën kritike ka qenë tek babai i të ndjerit F.it, tek Rr., ku të pranishëm kanë qenë edhe gratë e dajve mysafirë, Rr., gruaja e tij dhe motra e saj e madhe Z.J, rastësisht ka dalur në korridor, dera e hyrjes së shtëpisë ka qenë hapur dhe e ka dëgjuar A.in duke thirr o babë dhe menjëherë ka vrapuar tek A. në oborr të shtëpisë së F.it, kur ka dalu nga oborri për në rrugë, e ka pa F.in të përgjakur, duke ardhur në drejtim të shtëpisë dhe duke e mbajtur me dorë pjesën kah zemra, dhe dëshmitares i ka thënë se e ka ther B.1u, në ato momente e ka parë të akuzuarit B.1un dhe vëllaut të tijë B.2n, si dhe djali i agjes së tyre, tani dëshmitarin M., të cilët kanë qenë në distancë rreth 4 metra nga tani i ndjeri F., të njëjtëve ju është drejtuar me fjalët “Zoti ju marroftë çfarë keni bërë”, ndërsa që B.2a e ka marrë një kockë të betonit dhe e ka gjuajtur në drejtim të dëshmitares, mirëpo dëshmitarja e ka marrë F.in dhe e ka ulur para derës, ndërkohë ka dalur Rr. dhe gruaja e tij, Rr. e ka marrë veturën mirëpo nuk ka qenë në gjendje me vozit derisa ka ardhur djali i dytë i Rr., E. dhe e kanë dërguar tek mjeku F.in. Po ashtu ngjashëm ka deklaruar edhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me dt. 10.10.2019 dhe në Prokurori me dt.16.01.2020.

Gjykata ka vlerësuar, edhe dëshminë e kësaj dëshmitarja, dëshmi të cilën e gjetur të bazuar dhe atë vetëm sa i përket, faktit që para ngjarjes, familja R. dhe K., kanë qenë në raporte jo të mira ndërmjet vete, faktit se tani i ndjeri F.i ka thënë të njëjtës se e ka ther me thikë B.1a, me çka vërtetohet fakti se vërtete i akuzuari B.1, siç e ka pohuar edhe vetë, e ka ther me thikë tani të ndjerin F.. Ndërsa që sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së kësaj dëshmitarja, gjykata të njëjtën e ka gjetur të të pa mbështetur në provat tjera, pohime këto që kanë të bëjnë kinse me kërcënimet paraprake që B.2, ka bërë në drejtim të tani të ndjerit F., meqenëse duke pasur parasysh natyrën serioze të këtyre kërcënimeve të pretenduara, nuk rezulton se të njëjta janë paraqitur tek organet e ndjekjes, ndërsa që arsyeja që ka dhënë kjo dëshmitare se pse këto kërcënime të pretenduara nuk janë paraqitur te organe e ndjekës, nuk duke të besueshme, për me tepër që të njëjta pretendon se ja ka pohuar vetëm gruas së tani të ndjerit F., dëshmitares SH., ndërsa që dëshmitari S.K, ka deklaruar se para ngjarjes, derisa ka shkuar në shtëpinë e tani të ndjerit F., ka hasur në tani dëshmitaren SH. duke qajtur, e që i ka treguar se B.2a ka thënë se ka me vra F.in, ndërkaq që tani dëshmitari Rr., lidhur me këtë kërcënim, ka deklaruar se e ka kuptuar pasi që ka ndodhur ngjarja, në ditën kritike. andaj, gjykata një pohim të tillë të kësaj dëshmitarja e vlerëson të pa mbështetur në provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Dëshmitari S.K në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se të pandehurit B.1 i ka djem të motrës, ndërsa tani të ndjerin F.K djalë të vëllait, raportet ndërmjet i kanë pasur të këqija, si rrjedhojë e blerjes së pronës nga SH.R, në mexhë me familjen K., dhe mbylljes së rrugës, të

cilën kjo familje e kishte shfrytëzuar deri atëherë, e cila pronë ka qenë private sipas letrave mirëpo kur e ka blerë Rr. atë pronë aty ka qenë rruga ku është edhe sot është e njëjta rrugë dhe s'ka asnjë ndryshim që nga viti 1999. Më tutje ka shtuar se s'bashku me vëllain e tij Rr., SH.t i janë dërguar si ndërmjetësues, me c' rast është arritur një marrëveshje gojore që Rr. me shfrytëzua 4 metra rrugë, mirëpo që kjo marrëveshje nuk është zbatuar nga familja R., pasi që B.2a i ka vendosur pengesa në rrugë F.it, duke ja pamundësuar hyrjen në shtëpi, e që për këtë policia është njoftuar shumë herë, të cilët kanë ardhur edhe e kanë qetësuar gjendjen përkohësisht. Ka shtuar se është tentuar që të arrihet një marrëveshje e cila do motorizohej mbi të drejtën e kalimit nga ana e familjes K., mirëpo që nuk është arritur pajtim, pasi që familja R. ke pretenduar që gjoja se ne po e lëshojmë rrugën deri në atë ditë që na vyen neve, ndërsa që tani i ndjeri F. nuk e ka pranuar këtë, por që SH. R. në mënyrë të një anshme, ka nënshkruar një deklaratë të noterizuar ku ka qenë prezent edhe vëllai i dëshmitarit, K.K, me të cilën i ka lëshuar 4 metra për këtë rrugë me kalu familja e Rr.. Më tutje ka shtuar se pas dy apo tre muajsh, derisa ka shkuar tek vëllai Rr. t'i vizitoj, e ka vërejtur Sh., gruan e tani të ndjerit F. duke quajtur, dhe pasi që e ka pyetur pse po qan dhe e njëjta është përgjigjur se B.1a i kish thanë motrës Ms që gjoja se kam me vra F.in, dhe se gjithë kohën F. i është penguar nga familja R., për çka është dashur në vazhdimësi ta thërrasin Policin, që sipas dëshmitarit e kanë thirru "100 here". Në ditën kritike, para ngjarjes ka i ka parë të akuzuarit B.1 dhe vëllaut të tij B.2, duke shtruar kocka dikund rreth 30 metra larg vendit të ngjarjes, dhe lidhur me ngjarjen është njoftuar nga djali i vëllait A. dhe i ka thënë se familja R. ka bërë fjalë me F.in, e më pastaj e ka thirre vëllai i F.it E. dhe më ka thënë se F. i ka ndërruar jetë. Edhe në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.25.06.2020, ngjashëm ka deklaruar lidhur me rrethanat për të cilat ka dëshmuar edhe në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata e ka vlerësua dhe dëshminë e këtij dëshmitari, dëshmi të cilën e ka vlerësuar se është në kundërshtim me provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, çka është e qartë se në gjithë dëshminë e këtij dëshmitari, është orientuar në përshkrimin e familjes R., përkatësisht të akuzuarit B.1 R., si shkaktar kryesore dhe të vetëm për gjithë ngjarjen, nisur nga veprimet e tyre, para ngjarjes, në mënyrën se si ky dëshmitar i ka përshkruar këto veprime. Ky dëshmitari, ka dëshmuar, vetëm për mosmarrëveshjet e familjes R. dhe K., para ditës kritike, duke pohuar se si familja R., kinse ja kanë bllokuar rrugën familjes K., se në vazhdimësi i kanë bërë pengesa, i kanë provokuar, ndërsa që familja K., dhe në veçanti tani i ndjeri F., thjesht ka kërkuar që të i lejohet e drejta e kalimi-rrugës, pasi që nuk ka pasur mundësi tjetër të daljes në rrugë. Dëshmia e këtij dëshmitari, është në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë, siç është dëshmia e dëshmitarit SH.R, e ne veçanti në kundërshtim me deklaratën mbi të drejtën e kalimit, të bërë në një mënyrë të një anëshme nga tani dëshmitari SH.R, me të cilën i njëjti ua pranon të drejtën e kalimit familjes K., çka vërteton se kërkesa e kësaj familje nuk ka qenë, thjesht e drejta e kalimit, dhe se familja R. ja ka njohur dhe pranuar në tërësi këtë të drejtë, po ashtu pohimi i këtij dëshmitari, se lidhur me pengesat e shkaktuar nga familja R. është informuar se paku "100 here", nuk mbështetë me asnjë provë tjetër, si mund të jenë, ndonjë denoncim i regjistruar apo rasti i hapur, ndërsa është në kundërshtim me pohimin e dëshmitarit SH.K, i cili në deklaratën e dhënë në Polici, ka deklaruar "...gjithmonë kur ka pasur mosmarrëveshje në mes familjeve, posaçërisht me babin e tij F.in, çdo here e ka lajmëruar policin dikush prej familjes R."

Dëshmitari V.T në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se të dëmtuarën SH.K, e ka motër dhe ka qenë në dijeni lidhur me problemet që ka pasur burri i saj tani i ndjeri F.me familjen R., ndërsa që në ditën kritike pasi është lajmëruar nga motra M. lidhur me ngjarjen, ka shkuar në vend të ngjarjes dhe aty ka parë shumë njolla gjaku deri tek shtëpia e F.it, si dhe sandalet e F.it qe kanë qenë 3-4 metra të ndara njëra prej tjetrës, ka marr motrën Shpresën me dy fëmijët e saj U. dhe R. dhe janë nis në drejtim të Emergjencës në Prishtinë, pasi që janë informuan që nga Lipjani F.in e kanë nisur për në Prishtinë, kur ka mbërrit tek qendra tregtare "Albi Mall", është

kontaktuar nga mjeku që ka qenë prezent në Emergjencën në Lipjan, i cili e ka njoftuar se F.i e ka gjendjen kritike, ndërsa që kur kanë arritur në emergjencë në Prishtinë, ka pasur shumë Polic, nuk i kanë lejuar të hynë brenda, dhe pas 20-30 min janë njoftuar se F.i nuk ka mund t'i mbijetojë plagëve.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, mirëpo e njëjta nuk është relevante lidhur me ngjarjen, dhe si e tillë përmes të njëjtës nuk vërtetohet ndonjë rrethanë e rëndësishme në këtë çështje penale. Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilët dëshmi e ka gjetur të sinqertë dhe objektive, mirëpo përmes të cilës nuk ka vërtetuar ndonjë rrethanë relevante në këtë çështje penale, meqenëse ky dëshmitar ka dëshmuar për rrethana pas ngjarjes, që si të tilla nuk ka qenë kontestuese dhe për me tepër janë të parëndësishme, sa i përket objektit të aktakuzës dhe veprimeve inkriminuese me të cilat ngarkohen të akuzuarit B.1 dhe B.2 R..

Dëshmitari M.R në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaraurt se kam qenë duke punuar tek SH. dhe duke i thyer beton dhe duke i hedhur mbeturinat nja 20metra në pronë të SH.t. Pasi që ka piskat djali i B.2së unë kam vrapua dhe kam shkua tek prona e SH.t dhe aty e kam gjete F.in duke e goditur (mshu) me një cevë të hekurit e rrumbullakët e cila ka shërbyer për me thurë ndonjë rrethojë dhe ka qenë e gjatë përafërsisht 50cm, ka qenë e rrumbullakët dhe e njëjta ka qenë si e ndryshkur. Kur jam shkua unë aty B.1a ish kanë duke u mbrojtur dhe i kish qu duart përpjetë dhe F.i ish kanë duke i mshu me qat cevë në krye pasi që F.i ka qenë më i gjatë. B.1a gjatë kësaj kohe u mbrojtke me duar. Kjo përlëshje nuk ka zgjatur më shumë se 3-4 sekonda sa i kam parë unë dhe janë ndarë. Pasi që janë ndarë unë B.1së nuk i kam vërejte diçka në dorë pasi që i njëjti ka qenë krejt gjak. Pasi që unë e kam kapur B.1në me largu, F.i e ka gjuajte cevën prapa neve dhe ceva ka ra në parking të komunës. F.in nuk e kam këqyr mirëpo B.1a ka qenë krejt gjak, pasi nuk jam kthyer mbrapa me këqyr F.in. Pasi janë ndarë unë e kam kap B.1në pasi i njëjti ka qenë i gjakosur. B.1në e kam dërgua para shtëpisë së vet. Pasi ishte krejt gjak dhe mendova që ishte rrezik të madh. Kur kam shkua unë e kam parë që prezent ka qenë edhe djali i F.it aty dhe ka qenë në gjendje të keqe, gjithashtu edhe B.2a. Kur e kapa B.1n për beli që ti ndaj nuk i kam parë asgjë në dorë B.1s dhe se mbetet në tersi pranë dëshmis dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar në dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i pandehurit B.1 e ka kushërinjtë, përkatësisht babai i tij e ka djalë të vëllai babin e të pandehurve SH.R, dhe se lidhur me problemet që kanë pasur me familjen K. nuk ka qenë në dijeni, mirëpo pas ballafaqimit me deklaratën dhënë në prokurori, faqe 3, paragrafi i tretë nga fundi ku ka deklaruar se “Kjo ka qenë hera e parë që kam gjuajtur beton në atë vend ndërsa për të tjerat nuk e di, mirëpo më kujtohet edhe një rast që ka ndodhur dy tri javë para ngjarjes kritike kur unë jam nis me kolicë për të gjuajtur bërllok në një vend tjetër tek kantat e bërllokut dhe F.i më pat thënë mos gjuaj kësajde dhe unë i kam thënë më fal dhe jam kthyer pa e gjuajtur bërllokun”, ka deklaruar se kjo është e vërtetë. Në ditën kritike, ka qenë duke punuar tek familja R., me B.2un duke thyer beton mirëpo edhe B.1a ju ka ndihmuar kohë pas kohe, përfshirë edhe bartjen me kolicë të betonit të thyer tek prona e tyre, 6-7 metra larg lokalit ku kanë qenë duke punuar dhe dikund 50-60 metra larg shtëpisë së F.it, dhe pas bartjes së 3 ose 4 karroca, ka dal F.i i cili dukej nervoz dhe i ka ka thënë kthehu mos e hudh aty, për çka dëshmitari është kthyer, dhe e ka njoftuar B.2n se nuk e ka lejuar hedhjen e copave të betonit, B.2a i ka thënë B.1së “Nuk e paska lënë”, B.2a dhe B.1a s’bashku kanë dal prej oborrit, B.2a që ka qenë i veshur me shorce të shkurta, e ka marr kolcen e padredhur dhe është nis më përpara, ndersa pastij është nisur B.1a që ka qenë më uniformë të punë, ndërsa dëshmitar ka hyrë në oborr, dhe ndërkohë ka dëgjuar britmën e djalit të B.2së duke thënë o babë dhe ka bërtit fort, ka vrapuar drejt tek ata dhe e ka parë F.in i cili kishte qenë duke e goditur B.1un me cevë të hekurit të rrumbullakët në kokë dhe B.1a sa mundej u mbrojke me duar sepse i ndjeri F.ka qenë shumë i gjatë 2 metra, mirëpo që lidhur me këto pohime është ballafaquar me deklaratën dhënë në Prokurori 24.09.2020, faqja 2, rreshti 5 nga fundi, ku ka deklaruar “...ka dal F.K i cili ishte pak nervoz dhe unë nuk i jam afruar shumë. F.i më është drejtuar me fjalët kthehu

dhe mos te shoh më këtu tu qit beton. Po ashtu kam dëgjuar fjalët se pa u marr vesh”, për të cilën ka deklaruar se kështu ka deklaruar, si dhe me deklaratën e dhënë në polici me dt.07.09.2019 ku ka deklaruar se “... unë kam shkuar menjëherë pas tyre kur kam dal dhe aty i kam vërejtur B.1un, B.2un, F.in, djalin e F.it dhe djalin e B.2s ishin aty”, për çka është përgjigj se ka dalur pasi që ka dëgjuar britmat e djalit të B.2së. Me tutje ka shtuar se F.in e kam parë duke e goditur B.1n me një cevë të hekurit në kokë, ngjyrë bronzi por jo e re dhe u doke si e kuqe e ndryshkur, dhe i njëjti kish qenë krejt gjak, djali i F.it ka qenë 5-6 metra më larg F.it dhe B.1së, ndërsa që B.2a ka qenë nja 3 metra më larg dhe nuk ka pasur asgjë në dorë, pastaj dëshmitari ka hyrë në mes dhe i ka ndarë, e ka marrë B.1n dhe e ka dërguar te shpija pasi që ky nuk mundur më, F.i ka gjuajtur me cevë të hekurit në drejtim tonin, por e njëjta ka rënë në parking, dhe se e gjithë ngjarja ka zgjatur rreth 1 minut, ndërsa që dëshmitari ka qenë prezent në 20-30 sekonda të saj, tek tani i ndjeri nuk ka vërejtur gjak, siç nuk ka parë asgjë në dorë të B.2s dhe B.1s. Edhe ne deklaratat e dhëna në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në polici me datë 07.09.2019 dhe në prokurori me datë 24.09.2020, pran të cilave ka deklaruar se mbetet në tërësi, ka deklaruar në mënyrë të ngjashëm lidhur me ngjarjen në ditën kritike, ndërsa që lidhur rrethanat të cilat nuk i ka përshkruar në mënyrë të njëjtë, është ballafaquar gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtim gjyqësor, ku edhe ka dhënë sqarimet e kërkuara.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive, meqenëse njëjta është në përputhje edhe me deklaratat që ky dëshmitar ka dhënë në procedurën paraprake, e po ashtu edhe me provat materiale të administruar në këtë çështje penale, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm, faktin se para momentit kritike, derisa dëshmitari ka qenë duke bartur dhe hedhur copat e betoni, tani i ndjeri F.ka dalur dhe ka kërkuar që të mos vazhdoj të i hedh të njëjta, se vendi ku i ka hedhur këto copa betoni, ka qenë disa metra larg, vendit që familja K., përkatësisht tani i ndjeri e ka shfrytëzuar si rrugë kalimi, dhe pastaj, se i akuzuari B.1 është goditur me cev të hekurit nga tani i ndjeri F., se B.2 nuk ka pasur asgjë në dorë, dhe se ka qenë pikërisht ky dëshmitari i cili ka tërhequr tani të akuzuarin B.1 nga vendi i ngjarjes, se i njëjti ka qenë i përgjakur nga goditjet e marra. Sigurisht pohimi i këtij dëshmitari, për sasinë e gjakut që ka rrjedhur nga koka e të akuzuarit B.1, është një ekzagjerim, pasi që kjo nuk mbështetë as nga njollat e gjakut të evidentuara vendin e ngjarjes, mirëpo fakti që ka qenë i goditur, dhe se mjeti se mjeti i goditjes ka qenë prej hekuri, rezulton edhe nga dëshmia e dëshmuarit E., e po ashtu, lëndimet e shkaktuar konfirmohen edhe nga Raporti i akt ekspertimit mjeko ligjore i dt.29.01.2020, pohimi i këtij dëshmitari, se nuk ka parë asgjë në dorën e të akuzuarit B.1, dhe as nuk e ka vërejtur se tani i ndjeri F.ka qenë goditur, nuk e zbehin besueshmërinë në dëshminë e të njëjtit, pasi që në gjithë dinamiken e ngjarjes, me gjithë ngarkesën emocionale që shkakton, është vështir për një person të perceptoj gjithë personat përzënë apo të gjitha rrethanat pjesë e ngjarjes së caktuar, derisa që dëshmitari deklaroi se ai nuk i kam parë asgjë në dorë apo që nuk ka vërejtur se tani i ndjeri F.është i lënduar, që kjo mbështetë edhe me faktin se tani i ndjeri ka qëndruar në këmbë, ndërsa që shpejtësia me të cilën është zhvilluar ngjarja, ka përjashtuar mundësin për perceptim të rrethanave në mënyrë më konkrete.

Dëshmitari F.R. në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se raportet ne mes familjeve nuk kanë qenë të mira, për shkak të pronës e cila ishte pas shtëpisë, ashtu që në mes vete nuk kanë folur 10 vite. Ne ditën kritike, para se me ndodhë ngjarja B.1 dhe B.2 kanë qenë duke hequr beton, dhe në momentin kritik, ka qenë duke pastruar shtëpi dhe ka parë vëllain të ndjerit F., E. nga dritarja i cili kishte qenë shumë i tmerruar në fytyrë, ka dal që të shoh se çka ka ndodhur, në ato momente ka ardhur M. dhe ka kërkuar çelësat e veturës Tauran, e cila ka qenë pronë e vjehrrit SH.R , ka dal jashtë dhe e ka parë B.1n të mbuluar me gjak, , Rr. dhe E. - vëllai i F.it, B.2a ka qenë shumë i zverdhur në fytyrë, por nuk e ka vërejtur që ka qenë i lënduar, mirëpo pas shkuarjes

në emergjencë në Lipjan i njëjti i ka treguar që s'po mundem me marr frymë se F.i e ka goditur, B.1a më ka thënë se lëndimet i ka marr me shpikë nga F.i. Pastaj kanë marr një udhëzim dhe kanë shkuar në Qendrën Emergjente në Prishtinë, ku edhe kanë kuptuar se ka vdekur tani i ndjeri F.i, në QKUK, kanë qëndruar për afërsisht 4 orë, pastaj ka ardhur policia dhe e ka kontrolluar veturën.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e kësaj dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur si dëshmi të singertë dhe objektive, e cila është në përputhje me deklaratën që kjo dëshmitare ka dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht me deklaratën e dhënë në Polici me dt.07.09.2019, dhe me provat tjera materiale, e nga e cila ka vërtetuar bindshme faktin se vërtete i akuzuari B.1 dhe dhe vëllau i tije B.2a , gjatë ngjarjes në ditën kritike kishin pësuar lëndime, përçka edhe kishin kërkuar trajtim mjekësor, siç vërtetohet dhe nga Raporti i akt ekspertimit mjeko ligjore i dt.29.01.2022, mbi lëndimet e pësura nga B.2 dhe B.R.1.

Dëshmitari E.R. në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.04.2023 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë dëshmisë dhënë gjatë shqyrtimit të kaluar ku ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë para objektit të familjes së tij, duke e thyer do beton së bashku me B.2, B.1 dhe M. i cili ka qenë duke e bartur betonin e thyer me kolicë, deri mbrapa shtëpisë, ku edhe e ka hedhur, dhe pas bartjes së për afërsisht 2-3 kolicave, M. është kthyer, me kolicen e mbushur, dhe i ka treguar B.2, se F. nuk po e len me hedh betonin, B.2a dhe B.1a kanë shkuar tek F.i, ndërsa që dëshmitari ka shkuar pas tyre. Më tutje ka shtuar se nëse është biseduar ndërmjet tyre dhe çka është biseduar, nuk ka dëgjuar edhe pse ka qenë në distancë 1-2 metra, po e ka parë se si F.i e ka kapur axhin- B.1n për gjyksi/fyti, dhe i ka mshu shpikë në kokë, shpik e cila ka qenë e hekurt, por dimensionet de ngjyrën nuk ka qenë në gjendje ta përshkruaj, pastaj, B.2 a që ka qenë prapa B.1së, me kolicë në dorë, e ka lëshuar kolicën dhe ka shkuar e ka shtyrë F.in për ta larguar nga B.1u, mirëpo F.i e ka goditur me shpikë në gjyksi, ngjarja ka vazhduar me kacafytjen në mes F.it dhe B.1s, i cili kryet e ka pasur përfundí, ndërsa F.i ka sjell në të, derisa ka dalur djali i F.it- A.i, i cili e ka goditur babain B.2n shuplakë, B.2a vetëm e ka shtyrë, ka ardhë prapë dhe i ka mshu grusht në fytyrë babit- B.2së, B.2 prapë e ka shtyrë dhe i ka thënë dëshmitarit ta thërras policinë, ndërsa në ato momente aty ka ardhur M. Dëshmitari lidhur me pohimet e tij rreth ngjarjes është ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici me dt.07.09.019, ku ka deklaruar se “Derisa punëtori jonë i quajtur M.R ishte duke zbrazur kolicën, ka dal nga shtëpia e tij F.K dhe i tha punëtorit ti nuk guxon me gjuajt këta cement këtu... atëherë ai tha nuk guxon dhe afër tij kishte qenë një shufër metali të cilin F. e kapi me dorë dhe me dorën tjetër e ka kapur B.1 për gjoksi duke e goditur në kokë me shufër metalike dy herë... Axha B.1 e goditi F.in me boks dhe e rrëzoi në tokë dhe F.i u ngrit prapë. Axha u largua sepse kishte gjakderdhje në kokë...”, për çka ka deklaruar se e ka dëgjuar M.n kur i ka treguar babit B.2, se F.nuk po e len me zbrazë kolicen, se dëshmitari kur e ka parë për herë të parë F., me njëren dorë e ka kapur për gjoksi axhën- B.1 dhe me dorën tjetër e ka pasur shpikën në dorë dhe e ka godit, ndërsa që nuk i kujtohet te këtë deklaratë se “Axha B.1 e goditi F.in me boks dhe e rrëzoi në tokë dhe F.i u ngrit prapë”. Në deklaratën në Polici me dt.07.09.2019, sa i përket veprimeve para momenti kritik, ka deklaruar ngjashëm, duke pohuar se babai së s'bashku me axhën morën kolicen dhe shkaun tek vendi ku duhet të zbrazej kolica, aty dul F.i dhe i tha babait ktheu mrapa se këtu nuk ja ne shpraz kolicen, babai tha pse nuk bën, unë bash këtu ka me zbraz, atëherë ai tha nuk guxon, afër tij kishte qenë një shifër metali të cilën F.i e kapi në dorë, dhe me dorën tjetër e ka kapur axhin B.1un për gjokësi dhe e ka goditur në kokë me shufër metalike dy herë, atëherë babai im e ka lëshuar kolicen dhe e ka shtyrë F.in me duar dhe F.i dashti ta godas prapa xhin tim, babai ndërhyri mirëpo aty dul fjali i F.it dhe e godit babain tim me shuplak dhe boks në fytyr. Axhi B.1 e goditi F.in me boks dhe e rrëzoi në tok dhe F.i u ngrit prapë, axha u largua sepse kishte gjakderdhje në kokë, djalë i

F.it prapë e godiste babin tim, ndërsa babi im u largua sepse nuk dojke me godit djalin e F.it A.K. Në prezent në vendngjarje ka qenë B.R.1, B.R.2, F.K, A.K dhe vetë dëshmitari.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën në dëshmi e ka gjetur si dëshmi të sigurtë, reale dhe objektive, meqenëse ky dëshmitar njëjtë ka pohuar si në shqyrtim gjyqësor ashtu edhe në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, lidhur me ngjarjen të cilat i ka perceptuar në ditën kritike, e nga e cila dëshmi vërtetohet bindshme fakti se tani i ndjeri F., edhe të akuzuarit B.1, ju kishte kërkuar që të mos i hedhin copat e betonit, në vendin ku ka qenë duke i hedhur, punëtori i angazhuar nga ta, tani dëshmitari M., se ka qenë B.2, i cili ka insistuar për të hedhur, e që ka qenë edhe momenti kur tani i ndjeri F. ka i cili e ka kapur me një dorë për gjoksi tani të akuzuarin B.1, ndërsa që me dorën tjetër e ka goditur me cev të hekurt, të cilën e ka marrur në vendin ku është zhvilluar ngjarja, ndërsa që të akuzuarin B.2 e ka goditur me shipk në gjoksi, kjo rrethanë e pohuar nga dëshmitari është në përputhje, pjesërisht edhe me mbrojtjen e paraqitur nga i akuzuari B.1, e në veqanti me Raportin i ekspertizën mjekoligjore i dt.29.01.2022, mbi lëndimet e pësura nga tani të akuzuarit B.1; po ashtu ka vërtetuar faktin se i akuzuari B.1 e ka goditur me duar tani të ndjerin F., përçka edhe është rrezuar i njëjti, e që kjo është në përputhje edhe me vetë pohimin e të akuzuarit B.1, i cili me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes me dt.16.01.2022, ka pohuar se e ka goditur dhe shtyrë tani të ndjerin F.. Gjykata dëshmisë së këtij dëshmitari ja ka falur besimin në tërësi, meqenëse, sinqeritet dhe objektivitet i tij, rezulton edhe nga fakti që njëjti përshkruan edhe veprimet e kryera nga tani i akuzuari B.1, pra që njëri e ka goditur tani të ndjerin F., duke mos manifestuar kështu anëshmeri, në atë mënyrë që të i përshkruaj vetëm veprimet e palës tjetër. Po ashtu gjykata vëren se dëshmia e këtij dëshmitari, konfirmohet edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve tjerë. Në kohën kur ky dëshmitari është intervistuar në polici, ka qenë i moshës 14 vjeçare, moshë kjo në të cilën e ka poseduar aftësinë e perceptimit të kthjelluar të ngjarjes dhe rrëfimit të saj, me një besnikëri të mjaftueshme, e të njëjtën kohë, i zhveshur nga ndikimet dhe qëllimet, që këtë ngjarje të përshkruaj, në interes të akuzuarve, njëri nga të cilët është edhe babai i tij. Gjykata në këtë drejtim patë parasysh edhe pohimin e këtij dëshmitari se tani i akuzuari B.1 e ka goditur me grusht tan të ndjerin F. për çka edhe është rrezuar i njëjti, mirëpo ky pohim i dëshmitari nuk rezulton i vërtete meqenëse referuar Raportit të Autopsisë me nr. të referencës MA19-240, të datës 21.10.2019, Plotësim raportit të datës 30.09.2020 të F.Kt, nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë lëndim në trupin apo kokën e tani të ndjerit F., që ka mundur të jetë i shkaktuar me goditje nga duart, ndërkaq që nëse rrezuara ka ardhur si pasoj goditjes atëherë, e njëjta është dashur të jetë aq e fort sa patjetër do ishte evidentuar lëndimi në trupin apo kokën e tij, e po ashtu siç ka pohuar dëshmitari M., i akuzuari B.1 e ka shtyr tani të ndjerin F., për çka edhe është përkulur i njëjti, dhe se sigurisht nisur nga vendi ku ka qenë dëshmitari, e ka perceptuar, si goditje një shtyre të tillë, derisa të nijetit kanë qenë duke u rrahur njëri me tjetrin. Mirëpo edhe ky pohim i këtij dëshmitari, vërteton sinqeritetin e tij me rastin e deklaramit në rrëfimin e ngjarjes, duke mos u ndikuar në afërsinë familjare, për të pohuar gjitha atë që ka arritur të perceptoj dhe mënyrën si e ka perceptuar gjithë zhvillimin e ngjarjes.

Gjykata nuk ju fali besimin deklaratave të dëshmitarëve H.Z dhe N.V dhënë në polici me datë 10.10.2019, pasi që të pandehurve nuk ju është dhënë mundësia në fazën e hetimit të ushtrojnë pyetje edhe ta kundërshtojnë dëshminë e tyre, gjithashtu dëshmia e këtyre dëshmitare nuk objektivë pasi që të njëjtit nuk kanë qenë dëshmitar okular të rastit.

Nga deklarata për të drejtë kalimi me shenjen LRP.nr.5427/2018 e dt.13.07.2018, e bërë te noteri Zyfer Aliu, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar se pronari i paluajtshmëris ngas.kad.1740 ZK-Lipjan, SH.R ia lejon të drejtën e kalimit fqinjit të tij RR.K, në anën perëndimore, në gjersa prej 4 m nga stinori i ngastrës 1740-3. E drejta e kalimit ka karakter të përkohshëm që nënkupton

gjer në planifikimin e ndërtimeve të lartë, respektivisht ndërtimit të ndërtesave në këto ngastra, me atë rast do shuhet kjo e drejtë. Kjo e drejtë i jepet përfituesve RR.K dhe djemve të tij të cilët jetojnë në këtë ngastër. Deklarata është dhënë në prezencë të dëshmitarëve F.R. dhe K.K.

Gjykata ka vlerësuar edhe këtë deklaratë të administruar në cilësinë e provës materiale, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se familja R., ka shprehur gatishmëri, gatishmëri të cilën edhe e ka materializuar në deklaratë të noterizuar, përmes të cilës ja ka njohur dhe pranuar familjes K. të drejtën e kalimit, e që njëri nga dëshmitarët ka qenë edhe agja i tani të ndjerit F., K.K, mirëpo që nga përmbajtja e kësaj deklarate, dhe referuar edhe dëshmisë së dëshmitarit SH.R, vërtetohet bindshëm fakti se kërkesë e familjes R. nuk ka qenë vetëm e drejta e kalimit të papenguar, por kërkesë ka qenë pronësia në pjesën e përdorur si rrugë nga të njëjtit, dhe siç e ka pohuar edhe dëshmitari SH.R, referimi në objektet të larta, ka pasur të bëjë, me objekte banesore, në bazë të kontratës së ndërtimit, praktik kjo e zakonshme, tanimë, kur pronaret e parcelave japin truallin për ndërtim ndërtuesve të ndryshëm, kundrejt marrjes së sipërfaqeve të caktuara në objektet banesore.

Nga Raporti i ekspertimit nr. AKF/2019-2506/2019-2215 i datës 24.12.2019, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar që: Nga dëshmia MA19-240 është nxjerr profili i ADN-së së F.Karsniqi; Nga dëshmt VN#2, VN#4, VN#5, VN#6, VN#7, VN#8, VN#19, VN#19.2 dhe F.K#2 është fituar një profil i njëjtë i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së së F.K, kështu që F.K, nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këto dëshmi; Nga dëshmitë VN#3. VN#9, VN#11, VN#12, VN#13, VN#14, VN#15, VN#16, VN#17, VN#22.1, VN#23 dhe mostra VN#24.1 (njollë e kuqe/kaftë nga njëra gisht i dorëzës së djathtë) është fituar një profil i njëjtë i ADN-së nga një person i panjohur i gjinis mashkullore; Nga mostra VN#24.3 (tampon nga brendësia e dorëzës) është fituar një profil i ADN-së nga një person i dytë i panjohur i gjinis mashkullore; Nga mostra VN#24.2 njollë e kuqe/kaftë nga njëri gisht i dorës së majtë), është fituar një profil i përzier i ADN-së nga së paku dy persona F.K dhe personi i panjohur nga pika 3 e konstatimit, nuk mund të përjashtohet si kontribues të ADN-së në këtë përzirje; Nga dëshmia VN#20 nuk është fituar sasi e mjaftueshme e ADN-së për analiza të mëtejme; Nga dëshmia VN#18 nuk është identifikuar gjakë; Profilet e fituara të ADN-së nuk janë krahasuar me profilet në bazë të dhënave të ADN-së për arsye të problemve teknike në bazën e të dhënave të ADN-së.

Nga Raporti i ekspertimit AKF/2019-2506/2019-2216 i datës 20.01.2019, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se është bërë ekzaminimi i dëshmis F.K#1 një formë daktiloskopike me shenja të gishtërnijeve nga F.K dhe dëshmis VN#23 një thike me dorëz me ngjyrë të kuqe, ashtu që rezultati është që në dëshmin VN#23 nuk ka pasur zhvillim të vijave papilare.

Raporti i ekspertimit AKF/2019-2506/2019-22217 i datës 13.02.2020, vërtetohet se dëshmia F.K#2 një fanellë e bardhë e gjakosur me një vrim depërtuese në anën e majtë e marrë nga F.K; dëshmia F.K#3- Një nën këmishë e bardhë e gjakosur me një vrimë depërtuese në anën e majtë e marrë nga F.K; dëshmia VN#23- Një thikë me dorëz me ngjyrë të kuqe. Pas matjeve të bëra është konstatuar se vrima në dëshminë F.K#2 ka gjatësinë 18mm, vrima në dëshminë F.K#3 ka gjatësin 17 mm dhe gjërësia e tehut të thikës dëshmia VN#23 fillon nga 12mm, vazhdon duke u zgjeruar në 17mm dhe përfundon në 18mm.

Gjykata ka vlerësuar edhe raportin e ekspertimit AKF/2019-2506/2019-2215 të datës 24.12.2019, raportin e ekspertimit AKF/2019-2506/2019-2216 të datës 20.01.2019 dhe raportin e ekspertimit AKF/2019-2506/2019-22217 të datës 13.02.2020, e nga të cilat raporte ka vërtetuar bindshëm faktin se nga njollat e gjakut, të evidentuara në vendin e ngjarjes, janë nxjerr profile të caktuara të ADN-së, përkatësisht në njollat e gjakut, të cilat janë marr në pjesën, në vendin ku ka ndodhur ngjarja, janë fituar dy profile të ADN-së njëra nga të cilat ka rezultuar e përputhshme me profilin e ADN-së së tani të ndjerit F., ndërsa që pofili tjetër i ADN-së, është konstatuar si i

panjohur, kjo pasiqë nga tani i akuzuari B.1 R. nuk rezulton të jetë marrur ndonjë profil i ADN-së, e që bazuar në dheshmit e dëshmitareve E. dhe M.R., si dhe në Raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 07.09.2019 dhe Lista e dëshmimeve e datës 07.09.2019, me besueshmëri të lart rezulton se kjo njolla gjaku kanë qenë të tani të akuzuarit B.1, kjo pasi që njolla të gjakut janë evidentuar nga vendi i ngjarjes e në vazhdimësi deri te oborri i shtëpisë së familjes R., qe ka qenë edhe rruga që e kanë përshkuar tani të akuzuarit B.1 dhe B.2 pas ngjarjes. Po ashtu vërtetohet bindshme fakti se profili i ADN-se se tani të ndjerit F. është përputhur edhe me njollat e gjakut të evidentuar deri në shkallet e shtëpisë së të njëjtit, e që vërtetohet se i njëjti ka lëvizur në drejtim të dyerve të oborrit të shtëpisë së tij, dhe është ndalur tek shkallet e oborrit, siq dëshmohej edhe nga dëshmit e dëshmitarve M.O, Rr. dhe A.K.

Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 07.09.2019 dhe Lista e dëshmimeve e datës 07.09.2019, e Policis së Kosovës-Njesia e Forenzikës, janë evidentuar në vendin e ngjarjes dëshmit si në vijim: VN#1 është evidentuar një grumbull copëza betoni të hedhura në hapësirën të hapur për ballë shtëpisë së B.1 R. afër këndit të parkungut të KK-Lipjan; VN#2; VN#3 dhe VN#4 janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin afër këndit të parkingut të komunës, pjesë e të cilit përdorej si rrugë nga ana e familjes K.; VN#5- janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin në fillimin e rrugës me kubza ndërmjet shtëpive K. dhe R.; VN#6 dhe VN#7- janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin para dyerve të oborrit të familjes K.; VN#8- janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin para derës kryesore të shtëpis së viktimës F.K; VN#9; VN#10# dhe VN#11; VN#12; VN#13 dhe VN#14- janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin në parkingun e kuvendit Komunal, në anën jug-lindore të oborrit të shtëpis së të dyshuarit B.1 R.; VN#15 janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin në oborrin, brenda dyerve të oborrit të shtëpis së të dyshuarit B.1 R.; VN#16 dhe VN#17 janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin në oborr, për ball derës kryesore të shtëpis së të dyshuarit B.1 R.; VN#18 janë evidentuar pikat e kuqe të ngjatjshme me gjak, nga të cilat me anë të tamponit të satirizuar, të zhytur në ujë të distiluar është marr mostra e mundshme e ADN-së, këto pika ishin para derës së puntoris së të dyshuarit B.1 R.; VN#19 është evidentuar një sandale e këmbës së djathtë me ngjyrë hiri në madhësi 12-45 e cila ishte në fillim të rrugës me kubza ndërmjet shtëpive të familjeve R. dhe K.; është evidentuar një tamponit të satirizuar, i zhytur në ujë të distiluar me të cilin është marr mostra e mundshme e ADN-së, nga pika e kuqe e cila ishte në sandale; VN#20 është evidentuar një sandale e këmbës së majtë me ngjyrë hiri në madhësi 12-45 e cila ishte në fillim të rrugës me kubza ndërmjet shtëpive të familjeve R. dhe K.;

Dëshmit e gjetura në veturën Tauran pronë e B.1 R.: VN#21 është evidentuar vetura Tauran me ngjyrë të bardhë, me targa ... pronë e SH. R., e cila ka qenë e ndaluar dhe parkuar afër hyrjes së QKUK-së në Prishtinë; VN#22 është evidentuar një njoll e kuqe e ngjatjshme me gjakune cila ishte në ulësen e pasme të majtë, në veturën Tauran të evidentuar në VN#21; VN#21.1 është evidentuar një tamponit të satirizuar, i zhytur në ujë të distiluar me të cilin është marr mostra e mundshme e ADN-së nga njolla e evidentuar me VN#22; VN#23 është evidentuar një thikë me gjatësi totale 20cm, me dorëz me ngjyrë të kuqe dhe me maje dhe teh të gjatësisë 9cm dhe gjërësi

në mes 1.5cm në të cilën shiheshin njoola të kuqe të ngjajshme me gjakun. Kjo dëshmi është gjetur në dollap, nën ulësne e parë të naës së djathtë në veturën Tauran; VN#24-janë evidentuar një palë dorëza pune ngjyrë të kuqe dhe të zezë, të cilat janë gjetur mbi ulësen e parë të anës së djathtë, në veturën Tauran;

Nga Skica e vendit të ngjarjes dhe tabela e matjeve në vendin e ngjarjes e datës 07.09.2019, vërtetohet se në të njëjten, janë paraqitur në mënyre grafike, shtepit e familjes R. dhe K., distanca ndërmjet tyre, vendet ku janë evidentuar dëshmit e gjetura në vendin e ngjarjes e të përshkruara në Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes.

Gjykta ka vlerësuar edhe Raportin i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 07.09.2019, Listen e dëshmimeve e datës 07.09.2019, të Policis së Kosovës-Njesia e Forenzikës, Skicen e vendit të ngjarjes dhe tabelen e matjeve në vendin e ngjarjes e datës 07.09.2019, nga të cilat ka vërtetuar bindshmë vendin ku ka ndodhur ngjarja, gjësendet e evidentuara në vendin e ngjarjes, pikat e ngjajshme me pika gjaku, të cilat janë shënuar me numra në vendin ku janë evidentuara, madhësin dhe gjerësin e tyre, si dhe vendin ku janë gjetur, pastaj, fakti se në veturën e tipit Tauran, me të cilën janë bartur tani të akuzuarit B.2 dhe B.1, është gjetur thika me gjatësi totale 20cm, e cila tanimë pakontestueshme ka vërtetuar faktin se është përdor nga tani i akuzuari B.1 për ta goditur tani të ndjerin F., siq e ka pohuar edhe vetë ky i akuzuari B.1, se vërtete tani të ndjerin F.e ka goditur me thikën e cila është sekuestruar nga organet e ndjekjes.

Nga fotoalbumi i vendit të ngjarjes i Policis së Kosovës-Njesia e Forenzikës, vërtetohet se fotografit në kuadër të njëjtit paraqitet vendin ku ka ndodhur ngjarja, dëshmit e evidentuara dhe vendi ku janë evidentuar, qoft sa i përket njollave të gjakut, e po ashtu edhe dëshmime tjera siq janë sandallet e evidentuara në vendin e ngjarjes, pastaj, vetura e tipit Tauran, e cila ka qenë e parkuar në QKUK në Prishtinë, njollat e gjakut të evidentuara brenda të njëtes, dorzat, si dhe thika e cila është gjetur në fijokun e ulëses së karrikes së bashkëudhëtarit, me dorëz të kuqe dhe gjatësi 20 cm. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila po ashtu ka vërtetuar pakontestueshme vendin ku ka ndodhur ngjarja, në ditën kritike, gjësendet prezentë në atë vend, pastaj, vendin ku janë hedhur copat e betonit, nga tani dëshmitari M., që siq vërtetohet ky vend ka qenë disa metra larg vendit ku ka ndodhur ngjarja, pastaj, njollat e gjakut në veturën Tauran, cka vërteton për lëndimet e pësura nga tani i akuzuari B.1, për të cilat edhe ka kërkuar trajtim mjekësor, si dhe thika e cila ka shërbyer si mjetë për kryerjen, e cila është gjetur pikërisht në veturën me të cilën i akuzuari B.1 është derguar për trajtim mjekësor.

Nga Raporti i autopsisë nr.MA19-240 i datës 21.10.2019 dhe Plotësim raporti i datës 30.09.2020, të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Naim Uka, vërtetohet se në të njëjtin është bërë përshkrimi i:

- dëmtimeve të jashtme, të tani të ndjerit, ashtu që është konstatuar se tani i ndjeri F.ditën kritike ka pësuar katër lëndime. dëmtimi i parë është konstatuar në regjionin e sipër të majtë të gjoksit, plagë sipërfaqësore prerëse me përmasa 2.5x 0.2 cm me formë harkore dhe përngjyrim kafe; dëmtimi i dytë ceket në regjionin e sipër dhe të majtë të gjoksit 122 cm nga shputa e këmbës dhe 10 cm nga vija e mesme, plagë prerëse shpuese me përmasa 1.7 x 0.8 cm, me buzë të rregullta formë sferike me drejtim pjerrtas nga poshtë lart, nga djathas në të majtë dhe përngjyrim të kuqrremtë, gjakmbledhje me ndrydhje të indeve të buta me përmasa 30x30cm me përngjyrim të kuqrremtë. dëmtimi i tretë është në regjionin nën plagën prerëse shpuese, plage prerëse siperfaqësore me përmasa rreth 2.2 x 0.2cm në formë lineare dhe përngjyrim kafe. Dëmtimi i katërt potencohet në regjionin e mesit të shpinës, gërvishtje më përngjyrim kafe dhe përmasa 1x1cm.
- Dëmtimeve të brendshme janë konstatuar tri: 1.në regjionin e majtë të kraharorit-plagen prerëse sh[puese, mes brinjës VI dhe VII, me thellësi rrrth 1.80cm, e cila tejshkon indet e buta, cipen e qeskës së zemrës dhe muskulin e zemrës, duke depërtuar në barkushe e

djathtë të zemrës; 2. Në regjionin e majt të barkushës së djathtë, konstatohet plagë tejshkuese prerëse shpuese, e cila krijon kanal in e plagës me hyrje në barkushen e djathtë; dhe 3.gjakëderdhje e brendshme dhe e jashtme në regjionin e krahavorit.

Shkaku i vdekjes së tani të ndjerit F.K ka ardhur si rezultat i gjakëderdhjes së brendshme dhe të jashtme nga regjioni i majtë i krahavorit (zemra), si pasoj e plagës tejshkuese prerëse shpuese ne regjionin e majtë të krahavorit (zemrës), e shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetetit të fort, të mprehtë dhe me maje-thikë.

Nga Plotësim raporti i datës 30.09.2020, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar që të dhëant e autopsisë janë shoqëruar me fotografitë në color dhe skicën shoqëruese, në të cilën regjistrohen të gjitha dëmtimet gjate ekzaminimit të brendshëm dhe të jashtëm të trupit. Gjatë zhvillimit te procedurës së autopsisë në regjionin e kokës nuk është konstatuar ndonjë dëmtim traumatik.

Nga Akt Ekspertimit mjekoligjor-raporti mjekoligjor bazuar në rekonstruimin e vendit të ngjarjes i dt.28.01.2022 i ekspertit mjekoligjor Naim Uka, pas analizimit të të gjitha raporteve të dorëzuara nga Njesia e Forenzikës, e posaqarisht CD-së së rekonstruimit të vendit të ngjarjes dhe raporteve tjera të ekzaminuara të vendit të ngjarjes, mostrave te marra (njollave të gjakut) dhe dëshmime tjera (thikës), raporti të autopsis MA19-240 të dt.21.10.2019, plotësim raporti të autopsisë të dt.30.09.2020, fotodokumentacionit, konstatojm:

1. Pozita e tanimë të ndjeri në momentin e plagosjes me mjetin e fortë dhe të mprehtë, ka qenë pozitë e kërrusur, duke pasur parasysh gjatësin e tij prej 192 cm, në krahasim me gjatësin e të akuzuarit. Dallimi në gjatësi mes të akuzuarit dhe të ndjerit e përjashton mundësin e pozitës vertikale si të akuzuarit, poashtu edhe tanime të ndjerit.
2. Bazuar në gjetjet mjekoligjore nga raporti dhe skica e autiopsis, ku janë konstatuar plagët, 3 plagë në regjionin e majtë të krahavorit: në regjionin e sipër dhe të majtë të gjoksit 122 cm nga shputa e këmbës dhe 10 cm nga vija e mesme, plagë prerëse shpuese me përmasa 1.7 x 0.8 cm, me buzë të rregullta formë sferike me drejtim pjerrtas nga poshtë lart, nga djathas në të majtë dhe përngjyrim të kuqremtë, gjakmbledhje me ndrydhje të indeve të buta me përmasa 30x30cm me përngjyrim të kuqremtë; në regjionin e sipër të majtë të gjoksit, plagë sipërfaqësore prerëse me përmasa 2.5x 0.2 cm me formë harkore dhe përngjyrim kafe; dhe në regjionin nën plagën prerëse shpuese, plage prerëse sipërfaqësore me përmasa rreth 2.2 x 0.2cm në formë lineare dhe përngjyrim kafe.

Me besueshmëri konstatohet se gjatë rrahjes, tanimë i ndjeri është goditur 3 herë. Plaga 1 dhe 3 janë plagë përshkruese, kurse goditja vdekjeprurëse është plaga nr.2 e cila me besueshmëria është shkaktuar nga goditja e 3-të. Plagët 1 dhe 3 janë, shkaktuar parës vdekëprurës me nr.2. ky konstatim bëhet edhe me i besueshëm kur analizohet mjeti konfiskuar “Thika me gjatësi totale 20cm, me dorëz me ngjyrë të kuqe dhe me the me gjatësi 9cm dhe gjërsi në mes 1.4cm, në të cilin shiheshin njolla të kuqe të ngjajshme me gjakun (proba VN#23), në listën e dëshmimeve të zingjirit të ruajtjes së dëshmimeve të Njesisë së Forenzike të Policisë dhe thellësia e plagës së përshkruar në raportin e autopsisë me përmasa rreth 1.8cm.

Plaga e 4-të e përshkruar në raportin e autopsisë “ne regjionin e mesit të shpinës konstatojmë gërvishje me përngjyrim kafe dhe përmasa rreth 1x1cm, nuk ka lidhshmëri me kohen e rrahjes, bazuar në rekonstruimin e vendit të ngjarjes dhe deklaratva etë të gjithë dëshmitarve.

Po ashtu, bazuar në të gjitha provat e grumbulluar dhe rekonstruimi i vendit të ngjarjes, me besueshmeri konstatojmë se përjashtohet mundësia e ndonjë dëmtimi tjetër në trupin e tanimë të ndjerit.

Ekspertit mjekoligjor Dr. Naim Uka, i cili është përpilues i Raportit të Autopsisë me nr. të referencës MA19-240, të datës 21.10.2019, Plotësim raportit të datës 30.09.2020 të F.Kt, dhe Akt Ekspertimit mjekoligjor-raporti mjekoligjor bazuar në rekonstruimin e vendit të ngjarjes i

dt.28.01.2022 i ekspertit mjekoligjor Naim Uka, është dëgjuar në seancën e shqyrtim gjyqësor, ku ka përshkruar procedurën e kryerjes së një autopsie në të gjitha etapat e ekzaminimeve mjekoligjore, faktin se të gjitha gjetjet mjekoligjore shkruhen në formularin e raportit të autopsisë, kurse incizimet bëhen vetëm në raste specifike dhe ato kryhen kryesisht nga Policia. Pastaj ka përshkruar, konkretisht, natyrën dhe vendin e dëmtimeve të jashtme dhe të brendshme të cilat i ka pësuar tani i ndjeri F., e të cilat janë përshkruar edhe në raportet e referuara më lartë, duke theksuar se karakteristikat e plagës 1 dhe 3 referuar si në raportin e autopsisë janë të ngjashme mes njëra tjetrës ngase të dyja janë plage prerëse sipërfaqësore, të shkaktuara nga veprimi mekanik i një mjeti të fortë dhe të mprehtë, ndërsa që plaga numër 2 është plaga prerëse shpuese, që sipas karakteristikave të saj është shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të mprehtë me teh dhe me maje, kurse që është jashtë fushës së ekspertit mjekoligjor të deklarohet decidivisht për atë lloj mjeti. Më tutje ka shtuar se gjatë procedurave të autopsisë, besueshmëri të lartë profesionale deklaroj se nuk është konstatuar asnjë gjakmbledhje qoftë nënlekturore apo në regjionin e pasme të kokës, dhe se Shkaku i vdekjes ka ardh si rezultat i gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme nga regjioni i majtë i kraharorit (Zemra) si pasojë e plagës tejshkuese prerëse shpuese në regjionin e majtë të kraharorit, e shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të mprehtë dhe me maje- thikë. Po ashtu ka theksuar se gjithë karakteristikat e përshkuara në raportin mjekësor në mungesë të fakteve të ofruara para procedurave të autopsive mjekoligjore, nuk mund të deklarohet lidhur me pozicionit që ka mundur ta ketë i ndjeri në momentin e goditjes në raport me sulmuesin.

Gjykata ka vlerësuar Raportin e Autopsisë me nr. të referencës MA19-240, të datës 21.10.2019, Plotësim raportin e datës 30.09.2020, dhe Akt Ekspertimit mjekoligjor-raporti mjekoligjor bazuar në rekonstruimin e vendit të ngjarjes i dt.28.01.2022 të gjitha të përpiluara nga eksperti mjekoligjor Naim Uka, e po ashtu edhe sqarimet e të njëjtit të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, e nga të cilat ka vërtetuar bindshëm faktin se vdekja e tani të ndjerit ka ardhur si pasojë e gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme nga regjioni i majtë i kraharorit (Zemra) si pasojë e plagës tejshkuese prerëse shpuese në regjionin e majtë të kraharorit, e shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, të mprehtë dhe me maje- thikë, se në trupin e të ndjerit, janë evidentuar tri plagë/dëmtime, të cilat i janë shkaktuar të ndjerit në momentin kritik, dy nga të cilat janë plagë përshkuese/prerëse/sipërfaqësore, ndërsa që dëmtimi/plaga tjetër, është tejshkuese prerëse/shpuese në regjionin e majtë të kraharorit, e cila si e tillë është paraprir nga dy goditjet të cilat kanë len plage sipërfaqësore, dhe që të tri këto janë shkaktuar nga Thika me gjatësi totale 20cm, me dorëz me ngjyrë të kuqe dhe me gjatësi 9cm dhe gjerësi në mes 1.4cm, në të cilin janë evidentuar njolla gjaku, ndërsa që plag-gervishja e evidentuar me nr.4 të raportin e autopsisë, në regjionin e mesit të shpinës, nuk ka lidhshmëri me kohen kur ka ndodhur ngjarja, dhe se po ashtu vërtetohet bindshëm se në trupin e tani të ndjerit, nuk është evidentuar asnjë lloj dëmtim tjetër, në cilën do pjesë të tij, përfshirë edhe ndonjë goditje në qafë, në shpin apo në kokë.

Nga ekspertiza e gjeodezisë e dt. 24.01.2022 e Gjeldetit Izjah Shala, vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar që parcela me nr.... sipas skicave kadastrale shtrihet në drejtimin lindje-perëndim ne operatin kadastral evidentohet në emër të SH.R me sipërfaqe prej 433m2 në vendin e quajtur Varosh në ZK-Lipjan. Në Veri kufizohet me parcelën 01740-6 që evidentohen në emër të Komunës së Lipjanit, në lindje kufizohet me parcelën nr.1740 në pronësi të Komunës së Lipjanit, në jugë kufizohet me parcelën me nr.01736-0 po ashtu e evidentuar në emër të Komunës së Lipjanit, në perëndim, kufizohet me parcelën me nr.1740-3 e cila evidentohet në emër të SH.R në gjatësi prej 6.33 m, dhe me parcelën nr.01740-7 që evidentohet në emër të SH., A.K, në distancë prej 4.78m. ekspertizës i janë bashkangjitur edhe skica e pozicionit të parcelave të përshkruar me lartë, fleta posedues, kopja e planit, koordinatat përkufizuese të parcelës dhe ortofoto e viti 2018.

Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se vendin në të cilin ka ndodhur ngjarja, është parcela e evidentuar me nr. nr...., që si e tillë është në pronësi të SH.R, e që e njëjta kufizohet me parcelën nr.01740-7 që evidentohet në emër të SH., A. K., në distancë prej 4.78m, ndërsa që në përfundim, kufizohet me parcelën me nr.1740-3 e cila evidentohet po ashtu në emër të SH.R në gjatësi prej 6.33 m, e q është edhe distancë tokësore e cila ka shërbyer si rrugë kalim nga familja K.. Pra vërtetohet se ekziston një vazhdimësi pronësie duke qenë se SH.R evidentohet pronar i dy paluajtshmërive në fqinjësi në gjatësi prej 6.33 m, e cila vazhdimësi ndërpritet nga rruga që si e tillë është shfrytëzuar nga familja K., e që kjo përputhet dhe mbështetë edhe me pohimet e ekspertit Izjah Shala, të dhëna me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, i cili ka shpjeguar se çdo pronë/parcelë në atë hapësirë, ka dalje në rrugë dhe janë objektet e ndërtuara në skaj të rrugës që e pengojnë daljen, përfshirë edhe objektet e ndërtuara në parcelat në emër të familjes K..

Nga Raporti i akt ekspertimit mjeko ligjore i dt.29.01.2022, i ekspertit mjekoligjor Dr. Flamur Blakaj, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar që tani i akuzuari B.R.1 ka pësuar dëmtime-ndrydhje të indeve të buta të regjionit muror të kokës me plagë shquese në të njëjtën regjion, ndryshe të indeve të buta të shuplakes së dorës së majtë dhe gërvishtje në zogun e këmbës së majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit. Ndërsa B.R.2 ka pësuar lëndime-ndrydhje të indeve të buta dhe gërvishtje në regjionin e gjoksit, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fort, qe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila ka vërtetuar bindshme faktin se në ngjarjen kritike, tani i akuzuari B.1 dhe vëllai i tije B.2 kanë pësuar lëndime, lëndime këto të evidentuar sa i përket të akuzuarit B.1 në kokë, në shuplaken e dorës dhe në këmbë, ndërsa që i B.2 ka pësuar lëndime në gjokës, lëndime këto të lehta trupore, mirëpo të shkaktuar me mjet të fort. Kjo provë materiale është në përputhje me dëshmin e dëshmitarit E., i cili ka pohuar se e ka parë tani ndjerin F.qe me shufer te hekurit fillimisht e ka goditur B.1n në kokë, dhe pastaj e ka goditur edhe B.2 në gjokes, e po ashtu edhe dëshmitari M., i cili përveç që ka deklaruar se ka parë tani të ndjerin F.duke e goditur tani të akuzuarin B.1 në kokë, ka përshkruar edhe mjetin me të cilin është goditur, që sipas tij ka qenë cevë e hekurit, po ashtu kjo është në përputhje edhe me vetë pohimet e tani të akuzuarit B.1, i cilët me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, ka përshkruar goditjet e marra, që janë në përputhje të plotë me Raportin e akt ekspertimit mjeko ligjore, mbi lëndimet e pësuar nga të njëjtët.

Gjykata ka bërë edhe rikonstruksionin e vendit të ngjarjes me dt.16.01.2022, ku nga personat prezent, përkatësisht të akuzuarit dhe dëshmitaret, janë përshkruar fizikisht veprimet e tyre në ditën dhe momentin kritik, ashtu që, dinamika e zhvillimi të rikonstruksionit është bërë në përputhje me deklaratimet e dëshmitarëve dhe të akuzuarve, lidhur me veprimet e tyre në gjithë zingjirin kohor të zhvillimit të ngjarjes, ashtu që fillimisht është dëgjuar dëshmitari M.R., i cili sikurse edhe në shqyrtim gjyqësor, ka përshkruar veprimet deri në momentin kur i akuzuari B.1 dhe vallua i tije B.2 janë nisur në drejtim të tani të ndjerit F., pas njoftimi se i njëjti nuk e ka lejuar të i hedh copat e betonit që ka qenë duke i bartur me kolic. Pastaj, është dëgjuar dëshmitari E. R., i cili ka deklaruar se ka qenë duke ardhur nga pjesa para objektit, kur ka vërejtur tani të akuzuarin B.1 dhe vëllaut të tijë B.2në duke shkuar në drejtim të vendit ku ka ndodhur ngjarja, dhe se ky është nisur pas tyre, i cili ka shkuar deri në një distancë të caktuar, nga ku ka parë B.2n dhe B.1n, të cilët kanë qenë në vendin ku përfundon rruga e shtruar me koncka, dhe që është përdorur si rrugë, afër dyerve të tani të ndjerit F., po sa janë ofruar, tani i ndjeri e ka kapur axhin-B.1n për gjoksi dhe e ka goditur me shipk në kokë, B.2a ka qenë pas B.1s me kolic në dorë, e ka lëshuar kolicen, është nisur drejt tyre, në atë moment, është goditur nga F.i më cevë në gjoks, B.2a

është tërhequr mbrapa, kacafytja ka vazhduar në mes B.1s dhe F.it, ka dalur A. duke vrapuar, e ka goditur B.2n shuplak, i cili e ka shtyre, përsëri e ka goditur, dhe pastaj B.2a është tërhequr mbrapa dhe ka kërkuar nga dëshmitari që ta thërras policin, ndërsa që dëshmitari ka bërë titur o e myti babin dhe është nisur për thirru policin, ku gjatë shkuarjes është takuar me M.n. Më tutje, është dëgjuar dëshmitari A.K, që ka përshkruar se ka qenë duke shikuar tv brenda në shtëpi, e ka dëgjuar një zhurmë si rrumplim, kur ka dalur nga shtëpia, ka para B.2n dhe B.1n duke e sulmuar F.in, të cilët kanë qenë në vendin/vijen ndarëse me kocka, B.2a e ka goditur me stupc në kokë, ndërsa që B.1a ka qenë duke e therur me shtrafciger, ka tentuar edhe dy apo tri here tjera për ta ther, e po ashtu B.2a ka qenë duke i ndihmuar, ma tutje ka qenë E.R, pastaj është ofruar dhe është mundur ta kap F.in për dore, i cili ka qenë në këmbë duke e mbajtur plagen me dorën e djathtë, për ta tërhequr, kur edhe ka ardhur M.O, nga shtëpia e RR.Kt. Në ato momente ka parë që B.2a ka pasur strupc të drunit në dorë, ndërsa që B.1a ka pasur shtrafciger, dhe kanë vazhduar ta sulmojnë me gurë, e po ashtu edhe dëshmitari e ka sulmuar B.2n me gurë. Thikë nuk i ka pa kërkujt në dorë. Kur e ka goditur dëshmitari B.2n nuk ka opasur kurgju në dorë. F.i nuk është mbrojtë, veq e ka mbajtur plagen. Godtja ka qenë e fort, me dëshmitarin F.i nuk ka folur kurgju. B.2a pasi e ka goditur, e ka hedhur stupcin. Pastaj, dëshmitari M.e ka vazhduar përshkrimin e tij mbi ngjarjen, duke deklaruar se kur është nisur drejt vendin të ngjarjes, fillimisht ka parë E.in, i cili është nisur drejtë tij, ndërsa që më tutje ka qenë B.1a, B.2a, F.i, ndërsa që me larg ka qenë A.i, F.ka qenë i kthyer me fytyrë nga dëshmitari dhe duke e goditur me cev hekuri B.1n, B.1a ka qenë si i krrusur, duart mbi kokë dhe duke u mbrojtur, nuk ka pasur asgjë në dorë, B.2a ka qenë me i larguar, pas B.1s, dhe i habitur dhe vetëm ka shikuar, e ashtu ka qenë edhe A., në pjesën ku gjendet dalja nga oborri i shtëpisë së tyre, për një moment, F.i është ulur nga shtyrja e B.1s, dëshmitari e ka kapur B.1n i cili ka qenë i gjakosur edhe është nisur në drejtim të shtëpisë së familjes R.. Më tutje, duke ndjekur dinamiken e veprimeve të përshkruar nga vetë këta dëshmitar gjatë dëgjimin në seancat e shqyrtimit gjyqësor, është dëgjuar dëshmitarja M.O e cila ka pohuar se e ka parë A.i, tek qysh murit të oborrit, dhe e ka dëgjuar kur ka thirrur “oh babë”, duke menduar se është fjalosur më ndokënd, është nisur në drejtë tij, A.i ka qenë duke qëndruar në atë vend, ndërsa që tani i ndjeri F.ka qenë pak me tutje duke e mbajtur plagën, kur është kthyer në anën tjetër ka parë B.1n, B.2n dhe M.n, B.2a dhe B.1a nuk kanë pasur asgjë në dorë, dhe pasi dëshmitarja është kthyer përsëri tek F.dhe ju është drejtuar me fjalët “o B.2 cka keni bërë zoti ju marroft”, të njëjtit e kanë gjuajtur me kockë, ka marru F.in dhe e ka dërguar në shtëpi, përmes dyerve të oborrit të shtëpisë së tij, të njëjti i ka rrjedhur gjake dhe dëshmitares i ka thënë se e ka ther B.1a, ndërkohë që ka para RR. duke ardhur, mirëpo nuk ka qenë në gjendje me specifiku se në cilin moment ka ardhur i njëjti, pastaj ka dëgjuar dëshmitari Rr., që ka deklaruar se ka dëgjuar A.in duke thënë “ai ka me jav ba nanen kështu e kështu që ma keni ther babën”, është nisur drejt vendi të ngjarjes, ku ka hasur F.in, tek hyrje për në oborrin e tij, cili ka thënë se e ka therrur B.1a me shtrafsiger, i kanë ra do pika gjaku, M., ka qenë pas tij, ndërsa që A.in nuk e ka parë, ndërkohë që ka deklaruar se A.i ka dalur i pari, Minirja pas tij, dhe dëshmitari ka dalur i treti, pastaj e ka kap për dore tani të ndjerin F.dhe e ka futur në oborrin e shtëpisë së të ndjerit dhe e ka ulur në shkallët e shtëpisë, derisa ka ardhur E., dhe me veturën e dëshmitarit e kanë dërguar te mjeku, ndërsa që vetë dëshmitari. Dëshmitaret Rr. dhe M janë ballafaquar lidhur me momentin e dërgimit të tani të ndjerit deri tek shkallet e shtëpisë, duke qëndruar në pohimet e tyre, se të dy ata të vetëm njëri nga tjetër e kanë kapur F.in, dhe dërgimi deri te shkallet është bërë në anë të kundërta. Përsëri rikonstruksioni ka vazhduar me përshkrimin e dëshmitarit A., që ka deklaruar se kur kanë ardhur M. dhe Rr., ai ka qenë në anën tjetër të rrugës që është shfrytëzuar për kalim, ndërsa që i akuzuari B.1 dhe B.2ja dhe i ndjeri kanë qenë më larg, pikërisht në vendin ku përfundon shtruarja me kockë, në atë moment ka shkuar drejt F.it, të cilin ka filluar ta tërheq, pasi që e ka ofruar afër dyerve të oborrit, të ndjerin e kanë tërhequr Rr. dhe M., përmes dyerve të Rr., kanë kaluar në mes të oborrit dhe e kanë vendosur në shkallë, të akuzuarit kanë gjuajtur me gurë, dhe kanë goditur hallën M në këmbë, ndërsa që vetë dëshmitarja M, është

pyetur në atë moment nëse është goditur me guri, mirëpo e njëjta e ka mohuar se është goditur, por vetëm guri i ka ardhur te këmba.

Rikonstruksioni i vendit të ngjarjes ka vazhduar me përshkrimin e të akuzuarit B.1, mbi veprimet e tije në ditën kritike, para momentit kritik, gjatë ati momenti dhe pas tij, I akuzuari B.1 ka përshkruar se kur kanë shkuar deri në një distancë të caktuar e kanë vërejtur F.in, pasi që i janë ofruar, ju ka thanë kthenu, dhe vetë ka shkuar në drejtim të shtëpisë, dhe është kthyer më një cev në dorë, fillimisht i ka rën me boks në kokë, për çka i akuzuari B.1 është tërhequr mbrapa, pastaj e ka goditur dy here me cev B.2n, në zemër dhe në krah, është ofruar për ta ndalur, me c' rast edhe e ka goditur, sikurse që ai i ka goditur këta, i ndjeri F.i ka ra me shpik në kokë, për çka i ka dalur gjaku, është mundur të ta godas përsëri në kokë, mirëpo është mbrojtur me dorë, e ka goditur në këmbë, ashtu në gjendje të trullast, me vetëdije e pa vetëdije, në gjendje të gërrmosur, ka nxjerr thikën që ka pasur në xhep, dhe është mundur me tehë të thikës me largu dhe me siguri në atë rast e ka therur me thikën. Ka ardhur edhe djali F.it, të cilin edhe atë e ka shtyrë me dorë.

Eksperti Izjah Shala, ka bërë përshkrimin fizikë të ngastrave kadastrale, në fqinjësi me njëra tjetrën, në veçanti të parcelës nr. nr....., duke përshkruar në këmbë, shtrirje e saj, në gjithë hapësirën e sipërfaqes që përfshin, duke pohuar se çdo pronë/parcel në atë hapësirë, e ka pasur daljen në rrugë dhe janë objektet e ndërtuara në skaj të rrugës që e pengojnë daljen, përfshirë edhe objektet e ndërtuara në parcelat në emër të familjes K.. E që kjo është konfirmuar nga ndërhyrja e dëshmitarit Rr. derisa eksperti ka qenë shpjeguar se garazhden e kanë ndërtuar pasi që e ka blerë shtëpinë, dhe deri atëherë ka qenë e hapur, e mbjellë me lule.

Gjykata ka vlerësuar edhe përshkrimin e gjithë dinamikës së ngjarjes nga dëshmitaret, ekspertit të gjeodezis dhe të akuzuarve, të dhënë me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, ashtu që edhe përmes të njëjtave ka vërtetuar bindshme gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që përmbajtja konkrete e pohimeve të tyre, vlerësuar edhe në raport me dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtim gjyqësor apo në deklaratat e dhëna në procedura paraprake, është vlerësuar me rastin e vlerësimi të dëshmive të të njëjtëve, të përshkruar si më lartë në këtë aktgjykim, e që lidhur me rrethanat më të rëndësishme, në gjithë zhvillimin e ngjarjes, deklaratimet e të njëjtëve kanë qenë të ngjashme, sikur edhe dëshmitë në shqyrtim gjyqësor.

Sa i përket provave të administruara siq janë: Raporti i ekspertimit akf-2019-0368 i datës 14.02.2020, Raporti njoftues i datës 27.10.2019, Vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 07.09.2019, Shënimi zyrtar mbi hyrjen në banesë dhe lokale tjera i datës 07.09.2019 dhe ProcesverB.1 mbi kontrollin e personit dhe banesës i datës 07.09.2019, gjykata ka vlerësuar se të njëjta kanë krejt jo relevantet, në vërtetimin e ndonjë fakti të rëndësishme në këtë çështje penale,

Vlerësimi i provave

Nga këto prova e dëshmi, u vërtetuan rrethanat dhe atë si në vijim, se nuk rezulton fare kontestues fakti se i akuzuarit B.1 R., me tani të ndjerin kanë qenë në raporte familjare, përkatësisht tani i ndjeri F.ka qenë djali i dajës, e po ashtu nuk është kontestues as fakti se familja R. dhe familja K. kanë qenë në fqinjësi me njëra tjetrën, se raportet në mes tyre kanë qenë të keqësuar për një kohë të gjatë para ngjarjes në ditën kritike, përkatësisht nga koha e blerjes së parcelës neper të cilën ka kaluar rruga e cila është shfrytëzuar nga familja K..

Kontestuese në këtë çështje penale janë faktet si në vijim:

Cila ka qenë natyre e kërkesave të familjes K. në raport me familjen R., sa i përket të drejtës së kalimit nëpër parcelën e cila ka qenë në pronësi të SH.R, a kanë pasur mundësi tjetër kalimi

familja K. për të dalur përkatësisht për tu lidhur me rrugën kryesore, dhe familja R., përkatësisht tani të akuzuarit B.1, a ka penguar apo kërcënuar ndonjë here familjen K., përkatësisht tani të ndjerin F.dhe familjen e tij, për kalimin nëpër këtë rrugë?

Në ditën e ngjarjes, përkatësisht në momentin kritik, kur ka ndodhur ngjarja, të akuzuarit B.1, a kanë vepruar me dashje që ta privojnë nga jeta tani të ndjerin F., cilat kanë qenë veprimet e të akuzuarit B.1 ndaj tani të ndjerit F., dhe cilat janë qenë veprimet e të njëjtit në raport me të akuzuarin, dinamika e këtyre veprimeve në raport me njëra tjetrën, pastaj, numri i goditjeve që ka pësuar tani i ndjeri F., vendi ku i ka pësuar dhe mjete me të cilin i janë shkaktuar, po ashtu, natyre e lëndimeve të pësuar nga tani të akuzuarit B.1 dhe vallaut të tij B.2, dhe mjete dhe mënyra të cilat i janë shkaktuar të njëjtat?

Cilat kanë qenë veprimet e të akuzuarve B.1 pas ngjarjes, përkatësisht, ardhjes së personave tjerë, në vendin e ngjarjes, përkatësisht në raport me tani dëshmitaret M.O dhe A.K?

Përgjigjia në këto pyetje ndriqon në tanësinë e saj këtë çështje penale, prandaj gjykata në përpjekje që të gjejë të vërteten material, pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara në këtë drejtim, ka nxjerrë këto përfundime:

Sa i përket, natyrës së mosmarrëveshjeve paraprake, në mes familjes R. dhe familjes K., tani më pakontestueshme është vërtetuar fakti se familja R., ja ka pranuar dhe lejuar të drejtën e kalimit nëpër parcelën..., mirëpo që kërkesa e familjes K., ka qenë bartja në pronësi e kësaj pjesë të parcelës të cilën të njëjtit e kanë shfrytëzuar si rrugë, dhe se pengës për arritjen e marrëveshjes ka qenë pikërisht kjo kërkesë, që nuk është mjaftuar me të drejtën e kalimit, por ka pretenduar të drejtën e pronësisë, e që kjo vërtetohet dhe nga veprimi i familjes R., përkatësisht kryefamiljarit SH.R, i cili në mënyrë të një anshme, ka dhënë deklaratë me shenjen LRP.nr.5427/2018 e dt.13.07.2018, në të cilën konstatohet se familja K. do të kenë të drejtën e kalimit të papenguar, përveç në rast të ndërtimeve të larta, e që edhe vetë dëshmitari SH.R, ka pohuar se në vazhdimësi ka shprehur gatishmërinë për marrëveshje me familjen K., mirëpo që ka qenë e papranueshme për të që familjes K. të ua kaloj të drejtën e pronësisë mbi këtë pjesë, derisa që për familjen K., vetëm e drejta e pronësisë mbi rrugën, ka qenë garanci se familja R. në të ardhmen nuk do i pengoj për kalim nëpër atë pjesë të parcelës, dhe se kjo vërtetohet nga pohimet e dëshmitarëve SH.K e cila ka pohuar se kjo nuk ka qenë e mjaftueshme duke qenë se i kanë lanë mundësi në të ardhmen për me mbyll rrugën, pastaj, dëshmitari SH.K i cili në deklaratën në Polici me dt.30.09.2019 ka pohuar se deklarata ka qenë mashtruese, meqenëse kjo pjesë e parcelës ka vazhduar të mbetet në emër të SH.R. Po ashtu nuk rezulton e vërtetuar fakti se para ngjarjes, familja R., të ketë penguar familjen K., në shfrytëzimin e rrugës, dhe përtej deklaratave të dëshmitarëve R.K., S.K, A.K, SH.K, nuk rezulton të jetë bërë ndonjë denoncim tek organet e ndjekës lidhur me këtë, për me tepër, vetë dëshmitari A.K, gjatë dëshmish në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se "...ashtu konkret nuk ka dal askush nga familja R. të ju thotë të mos i bini asaj rrugë, mirëpo kanë dal fjalë se B.R.1 ka blerë armen për me vratë ndjerin babain tim", pastaj dëshmitari Rr., i cili ka deklaruar se atij nuk i kanë kërkuar që të mos kaloj neper rrugë, por tani të ndjerit F., ani pse të gjithë këta dëshmitar, kanë pohuar se i akuzuari B.1 dhe familjarët e tij kanë vendosur sende në rrugë, çka sikur të ishte e vërtetë, do të përbënin pengesë për të gjithë. Po ashtu, nga provat e administruar është vërtetuar bindshëm fakti se familja K. ka pasur mundësi tjera të lidhjes me rrugën kryesore, meqenëse parcelat pronar të cilave kanë qenë, janë të lidhura me rrugën kryesore, dhe fakti që kanë qenë të ndërtuara objekte nga vetë kjo familje, e duke ja pamundësuar vetës daljen ne rrugën kryesore, nuk ka qenë rrethanë e mjaftueshme për të pretenduar se nuk kanë pasur rrugë tjetër kalimi, përderisa trualli i tyre ka qenë i lidhur me rrugë, pra duke ndërtuar objekte në truallin e tyre ne pjesën që lidhet me rrugë, kanë vetë krijuar pamundësinë për kalim andej, dhe mbi këtij pamundësi, shkaktar të cilës kanë qenë vetë kjo familja, kanë pretenduar, jo vetëm të drejtën e kalimit, por për me tepër të drejtën e pronësisë,

mbi pronën e tjetrit, mirëpo përkundër kësaj, që kalimi nëpër parcelën e familjes R., nuk ka qenë as i nevojshme as i domosdoshëm, përsëri të njëjtit kanë shprehur gatishmëri, duke dhënë edhe deklaratë, të referuar si më sipër, ku ja njohin të drejtën e kalimit, zoton për të mos i penguar dhe e ruajnë vetëm të drejtën e pronësisë, e që kjo është vërtetuar edhe nga ekspertiza e gjeodezisë e dt. 24.01.2022 e Gjeodetit Izjah Shala dhe deklarimeve të njëjtit me rastin e rikonstruksionin e vendit të ngjarjes, i cili ka pohuar se çdo pronë/parcelë në atë hapësirë, e ka pasur daljen në rrugë dhe janë objektet e ndërtuara në skaj të rrugës që e pengojnë daljen, përfshirë edhe objektet e ndërtuara në parcelat në emër të familjes K.. E që kjo është konfirmuar nga ndërhyrja e dëshmitarit Rr. derisa eksperti ka qenë shpjeguar se garuzhën e kanë ndërtuar pasi që e ka blerë shtëpinë, dhe deri atëherë ka qenë e hapur, e mbjellë me lule.

Sa i përket dinamikës së ngjarjes në ditën kritike, pakontestueshme është vërtetuar se i akuzuari B.1 dhe vëllau i tij B., kanë qenë duke punuar, në objektin në pronësi të tyre, s'bashku edhe me dëshmitarin M.R, i cili ka qenë edhe personi i cili ka qenë duke bartur me kolic copa betoni dhe dërgimin e tyre në truallin, nëpër të cilën ka kaluar edhe rruga e pretenduar nga familja K., mirëpo që vendi i hedhjes, ka qenë disa metra larg vendit që është shfrytëzuar si rrugë kalimi, e që këto rrethana janë vërtetuar nga pohimet e vetë të akuzuarit B.1, dëshmitaret M.R si dhe vërtetohen edhe nga fotoalbumi i vendit të ngjarjes dt.07.09.2019, si rikonstruksioni i vendit të ngjarjes i zhvilluar me dt.16.01.2022, nga ku paraqitet largësia rrugës/vendit ku ka ndodhur ngjarja, me vendin ku janë hedhur copat e betonit të thyer, pastaj derisa tani dëshmitari ka qenë duke bartur copa të betonit me kolic, ka dal tani ndjeri F.dhe i ka kërkuar që të ndaloj se hedhuri copat e betonit në vendin ku ishte duke i hedhur, për çka, tani dëshmitari M. është kthyer me kolic të mbushur, dhe e ka informuar vëllaun e të akuzuarit, i cili pastaj e ka informuar të akuzuarin B.1n dhe s'bashku, B.2a e ka marr kolicen e mbushur, edhe janë nisur në drejtim të vendit ku ka qenë F.i, siç vërtetohet nga pohimet e të akuzuarit B.1 dhe dëshmitarit M., të cilët në mënyre krejt të njëjtë kanë përshkruar, gjithë dinamikën e ngjarjes deri në këtë moment, çka për gjykatën krijon bindjen e plotë për vërtetësinë e zhvillimit të ngjarjes deri në momentin e pikërishtëm. Pastaj, pasi që i akuzuari B.1 me vëllaun e tij, janë ofruar tek tani i ndjeri F., i njëjti ka përsëritur kërkesën që të mos zbrazët kolica dhe që të kthehen mbrapa, siç vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit Edmon R. i cili ka deklaruar “aty dul F.i dhe i tha babit (B.2s), kthehu mbrapa se këtu nuk ke me shpraz kolicen, babai i tha pse nuk bën, unë bash këtu ka me shprazë, atëherë ai tha nuk guxon...”, kjo rrethanë pjesërisht vërtetohet edhe nga vetë pohimet e të akuzuarit B.1 i cili në deklaratën në Polici me dt.07.09.2019, si dhe me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, ka pohuar se tani i ndjeri F.i ju kishte kërkuar të kthen, pastaj meqenëse i akuzuari B.1 dhe vëllaun i tij B.2a, nuk kanë vepruar sipas kërkesës së tani të ndjerit F., në atë moment, i njëjti ka marr cev-en e hekurit e cila është gjendur në atë vend, me një rënë dorë e ka kapur për gjoksi të akuzuarin B.1, ndërsa që me dorën tjetër e ka goditurme cev në kokë, njëherë në dorë dhe një herë në këmbë, rrethanë kjo e pohuar nga dëshmitari Edmon R., i akuzuari B.1, e që vërtetohet edhe nga Raporti i akt ekspertimit mjeko ligjore **i dt.29.01.2022, mbi konstatimin e lëndimeve, në kokë, në shuplaken e dorës dhe në këmbë, është ofruar për të ndarë tani vëllaun i të akuzuarit, B.2a, e të cilin tani i ndjeri F.e ka goditur me cev në gjoks, pasi këtij momenti, i akuzuari B.1 e ka nxjer thikën nga xhepi i tij dhe i ka realizuar tri** goditje, njëra nga të cilat edhe ka qenë fatale, për tani të ndjerin F., siç rezulton edhe nga vetë pohimi i të akuzuarit B.1, i cili ka deklaruar se është mundur fillimisht largoj duke manovruar me tehun e thikës, pastaj edhe e ka goditur, e që kjo konfirmohet edhe nga Raporti i autopsisë nr.MA19-240 i datës 21.10.2019 dhe Plotësim raporti i datës 30.09.2020, të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Naim Uka, sipas të cilës vërtetohen tri dëmtime, dy në forma gërvishje, dhe një goditje e cila ka qenë fatale, pastaj, nga dëshmia e dëshmitari E., por që konfirmohet po ashtu edhe nga Raporti i akt ekspertimit mjeko ligjore i dt.29.01.2022, në të cilin është konstatuar se lëndimet e pësuar nga i akuzuari B.R.1 ka pësuar dëmtime-ndrydhje të indeve të buta të regjionit muror të kokës me plagë shqyese në të njëjten regjion, ndryshe të indeve të buta të shuplakes së dorës së majtë dhe gërvishje në

zogun e këmbës së majtë, ndërsa vëllau i të akuzuarit, B.R.2 ka pësuar lëndime-ndrydhje të indeve të buta dhe gërvishje në regjionin e gjoksit, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fort, qe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin. **I akuzuari B.1 ka vazhduar të përleshet me tani të ndjerin F., duke e shtyrë, për çka tani i ndjeri fillimisht** është rrëzuar në tokë, por është ngritur përsëri, rrethanë kjo e vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit E., pastaj dëshmia e dëshmitarit M. cili ka pohuar se ka vërejtur kur për një moment është përkulur tani i ndjeri F., si dhe kjo rrethanë pohohet pjesërisht edhe nga vetë i akuzuari B.1, i cili me rastin e rekonstruksionit të vendit të ngjarjes ka pohuar se edhe ai e ka goditur meqenëse ka qenë i goditur nga i njëjti, ndërsa që djali i tani të ndjerit F., tani dëshmitari A., pas ardhjes në vendin e ngjarjes e ka goditur B.2, e që kjo rrethanë vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit E., si dhe nga pohimi i dëshmitarit A., i cili me rastin e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, ka pohuar se e ka sulmuar vëllaun e të pandehurit, B.2n me duar, dhe se ka qenë pikërisht vëllau i të akuzuarit B.1, B.2a, që ka kërkuar nga tani dëshmitari E., njoftimin e policisë mbi ngjarjen, siç vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit E. R., i cili edhe ka njoftuar Policin. Kjo dinamik e ngjarjes, e vërtetuar në mënyrë të drejt dhe të plotë, provohet nga dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, e pjesërisht edhe nga vetë i akuzuari B.1, pranin e gjithë këtyre në vendngjarje e pohon gjithsecili nga ta, përtej përshkrimeve të ndryshme, të rrethanave konkrete, për besueshmërinë e të cilave është dhënë vlerësim, në gjithsecilin nga këto dëshmi personale e prova materiale, e që një dinamik e tillë në gjendjen e vërtetuar të fakteve, mbështete edhe nga rrethana tjera, siç është fakti që nga Raporti i autopsisë nr.MA19-240 i datës 21.10.2019 dhe Plotësim raporti i datës 30.09.2020, dhe Akt Ekspertimit mjekoligjor-raporti mjekoligjor bazuar në rekonstruksionin e vendit të ngjarjes i dt.28.01.2022 të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Naim Uka, rezulton se përveç tri goditjeve, dy nga të cilat në formë të gërvishjtjeve, tani i ndjeri F.nuk ka pësuar ndonjë dëmtim që ka mundur të i shkaktohet nga godite eventuale të tani të akuzuarit B.1.

Mbrojtja e nevojshme dhe tejkalmi i mbrojtjes:

Prokuroria në aktakuzë pretendon se i pandehuri ka vepruar me dashje dhe se veprimet i kishte ndërmarr për të kryer veprën penale të vrasjes.

Të gjitha rrethanat e fakteve të paraqitura nga palët, duke u bazuar në provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale; Vrasje në tejkalm të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

Dispozita e nenit 12 të KPRK-së, ka përkufizuar mbrojtjen e nevojshme, kjo dispozitë ka përcaktuar kushtet dhe kriteret ligjore se kur, dhe në cilin rast ekziston mbrojtja e nevojshme dhe tejkalmi i saj.

Sipas kësaj dispozite ligjore për tu konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme duhet të ekzistoj:

- a. sulmi i kundërligjshëm real dhe i atëçastshme ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.
- b. sulm duhet të jetë i paprovokuar nga i pandehuri.
- c. mbrojtja duhet të ndërmerret vetëm në drejtim të sulmit përkatësisht sulmuesit dhe vetëm me qëllim të zmbarsjes së tij.
- d. mbrojtja duhet të jetë proporcionale ndaj sulmit në të kundërtën dispozita përcakton se kemi të bëjmë me dispropocionin e mbrojtjes në raport me sulmin e që shpërfaqet tejkalmi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

Bazuar në gjendjen e fakteve që ka vërtetuar gjykata në këtë rast, rezulton se ka ekzistuar sulmi i të ndjerit ndaj të pandehurit duke e goditur me cev të hekurit, pastaj, ka pasuar mbrojtja e të pandehurit ndaj sulmit, përmes përdorimit të thikës, gjë që kjo mbrojtje për shkak të rrethanave dhe mjetit të përdorur ka rezultuar në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme

Gjykata në këtë gjendje të vërtetuar të fakteve, ka bërë ri cilësimin e veprës penale, ashtu që ka vlerësuar se në rastin konkret jemi në kushtet e konsumimit të veprës penale Vrasje në tejkalim të kufijve të mbrojtjes të nevojshme nga neni 172 lidhur me neni 12 par.3 dhe 4 i KPRK-së, duke pasur parasysh se tani i akuzuari B.R.1, pasi që është sulmuar nga ana e të ndjerit F., i cili ka marr me dorë një cev të hekurit të rumbullakët të gjatë 50cm, ndërsa që me dorën tjetër e ka kapur të akuzuarin B.1 për gjoksi dhe e ka goditur me cev në kokë një herë, një herë në shuplaken e dorës, të cilën i akuzuari B.1 e ka vendosur mbi kokë për të mbrojtur nga goditja, dhe njëherë në këmbë, pastaj pasi që është ofruar vëllai i të pandehurit, B.2a të njëjtin e ka goditur njëherë në gjoks me gyp metali, dhe në atë moment i akuzuari B.1 e ka nxjerrë thikën nga xhepi i tij dhe e ka goditur 3 herë F.in. Trupi gjykues ka vlerësuar se kjo gjendje faktike e vërtetuar manifeston elementet e veprës penale të ri cilësuar, me vetë fakin se pasi që i ndjeri ka goditur të akuzuarin dhe më pastaj vëllain e tij B.2n dhe në momentin i pandehuri B.1 ka nxjerrur thikën nga xhepi duke e goditur të ndjerin 3 herë, 2 nga të cilat kanë rezultuar prerje sipërfaqësore, ndërsa që goditja e fundit, në pjesën e majtë të gjoksit në zemër, ka rezultuar vdekjeprurëse, gjykata vërteton faktin se me këto veprim të të pandehurit kemi të bëjmë me tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme, pasi që kemi ndërprerje të sulmit, ku i ndjeri pasi që ka goditur të akuzuarin B.1 dhe më pastaj vëllain e tij B.2n dhe në këtë moment kemi edhe ndërprerje të sulmit, ku i pandehuri B.1 nxjerrë thikën dhe godet tri herë të ndjerin ku njëra prej goditjeve ka qenë vdekjeprurëse.

Disproporcioni mes sulmit dhe zbrazjes së sulmit në këtë rast është tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme pasi që gjykata ka vërtetuar se momentin kur është goditur i ndjeri nga ana e të pandehurit nuk ka qenë duke e sulmuar të pandehurin e as vëllain e tij. Fakti se i pandehuri tejkalo vetëmbrojtjen vërtetohet edhe nga fakti se ai ishte goditur me ceven e hekurit një herë në kokë, një herë në dorë dhe një herë në këmbë mirëpo intensiteti i atyre goditjeve nuk ka qenë në drejtim të privimit të tij nga jeta, duke marr parasysh konstruktin fizik të të pandehurit dhe tani të ndjerit, pasi që i ndjeri në tërë atë rreth është njohur si një person shumë i përgatitur fizikisht, dhe kjo gjendje vërtetohet nga raporti i ekspertit mjekoligjor ku u konstatua se i pandehuri B.1 dhe vëllai i tij B.2a kanë pësuar lëndime të lehta trupore.

Vlerësimi i mbrojtjes

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e mbrojtjes së të akuzuarit B.1 se i pandehuri ka vepruar në mbrojtje të nevojshme Përkundër, se qëndrojnë faktet e vërtetuara se si ka rrjedhur ngjarja kritike, dhe fakti se i ndjeri kishte marrë ceven e hekurit që ishte gjendur në atë vend me një dorë e ka kapur për gjoksi të akuzuarin B.1, ndërsa me dorën tjetër e ka goditur me shufër metalik, njëherë në dorë dhe në kokë, për çka ishte afruar vëllau i të akuzuarit, B.2 duke e sulmuar, të cilin po ashtu i ndjeri e kishte goditur me cev në gjoks, por pas këtij momenti i akuzuari B.1 nxjerr thikën nga xhepi i tij dhe ka realizuar tre goditje që njëra ka rezultuar fatale. Në rastin konkret, përjashtohet mundësia që i akuzuari B.1 të ketë vepruar në mbrojtje të nevojshme gjykata vërtetoi se i pandehuri ka vepruar në tejkalim të mbrojtjes të nevojshme. Në anën tjetër, nuk kemi të bëjmë me vrasje të kryer në gjendje të tronditje të fortë mendore, për rrethana që ndërliken sikurse tek përjashtimi i kryerjes së veprës penale në mbrojtje të nevojshme. I akuzuari B.1 së bashku me vëllain e tij B.2n, afrohen tek i ndjeri pasi që dëshmitari iu tregon lidhur në problemin e shkarkimit së karrocës së betonit. Prandaj, mbetet i paqartë pretendimi i mbrojtjes, se cila rrethanë ka shkaktuar tronditjen e fortë mendore tek i akuzuari B.1. Përkundër, se goditjet e para i ka dhënë i ndjeri, megjithatë sikurse goditjet e njëpasnjëshme

të të akuzuarit B.1, fakti se të akuzuarit kishin shkuar së bashku tek i ndjeri, problemet që i karakterizonin palët në fjalë, ofron indicie se pritshmëritë për të pasur konflikt kanë qenë reale.

- Rrethanat për matjen e llojit dhe lartësisë dënimit:

Me rastin e matjes dhe llojit të lartësisë së dënimit gjykata ka marr për bazë të gjitha rrethanat si rrethana rënduese apo rrethana lehtësuese. Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin i ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit, në mbështetje të nenit 73 të Kodit Penal të Republikës Kosovës. Gjykata, si rrethanë rënduese për të pandehurin ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, që gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij. Si rrethanë tjetër rënduese ka gjetur intensitetin e dëmtimit përkatësisht vlerës se mbrojtur.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale e që këto rrethana kishin determinuar veprimin e të pandehurit që të ndërmerre veprim me qëllim të mbrojtjes së nevojshme e cila kishte rezultuar në tejkalim të kësaj mbrojtje, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata ka vlerësuar sjelljen e mëparshëm të kryerësit, siç rezulton nga shkresat e lëndës i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale. Rrethanë tjetër lehtësuese për gjykatën rezultojnë të jenë rrethanat e tij personale sjelljet e tij pas kryerjes se veprës penale, i cili jeton dhe bënë një jetë normale, si rrethanë lehtësuese, se i pandehuri kishte pasur sjellje korrekte me institucionet ligj zbatuese, Gjykata duke bërë vlerësimet e rrethanave e meqë ka konstatuar se vepra penale ishte kryer në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, që sipas paragrafit 4 të nenit 12. Për më shumë i pandehuri nuk e ka mohuar faktin se ka vepruar ne vetëmbrojtje (se thikën e ka përdorur për tu mbrojtur nga sulmi) të cilën gjendje e ka vërtetuar edhe gjykata, por se ka konstatua se ka tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

Bazuar në të gjitha këto rrethana gjykata ka shqiptuar dënimin ndaj të pandehurit sikurse në dispozitiv duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, konkretisht që kryesi do të parandalohet në kryerje e veprave penale në të ardhmen dhe do të arrihet risocializimi i tij, me anë të këtij dënimi po ashtu do të parandalohen personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlíkueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarës, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që pala e dëmtuar nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, dhe duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsëritshëm lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ps. Me aktvendim GJA.nr. 602/2023, është zgjatuar afati ligjor për përpilimin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2019:291608, 17.07.2023

Gjyqtari

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.